



**RAPORTI VJETOR**

**UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË**

**VITI AKADEMIK 2024/2025**

**DHJETOR 2025**

## PASQYRA E LËNDËS

HYRJE .....	3
<b>A. Raportimi i Senatit Akademik.....</b>	<b>4</b>
<b>a. REALIZIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE SIPAS PLANIT STRATEGJIK TË INSTITUCIONIT .....</b>	<b>4</b>
<b>b. MËSIMDHËNIA .....</b>	<b>14</b>
<i>-Përshatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit dhe me tregun e punës....</i>	<i>19</i>
<i>-Ndryshimet në statutin apo rregulloret e UMSH-së.....</i>	<i>21</i>
Ndryshimet në Statutin e UMSH gjatë kësaj periudhe kanë qenë të lidhura me ndryshimet strukturore të hapjes së Fakultetit të ri të Shkencave Mjekësore si dhe disa ndryshime strukturore si më poshtë:	
.....	21
- <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave.....</i>	<i>21</i>
- <i>Parashikimi për angazhimin e personelit akademik .....</i>	<i>28</i>
- <i>Gjurmimi i studentëve .....</i>	<i>35</i>
- <i>Këshilli studentor dhe përfaqësimi e tij në UMSH.....</i>	<i>37</i>
- <i>Klubet studentore .....</i>	<i>38</i>
<b>c. KËRKIMI SHKENCOR .....</b>	<b>40</b>
- <i>Bashkëpunime ndërinstitutionale .....</i>	<i>57</i>
<b>1. Projektet e finalizuar gjatë vitit 2024/2025 .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>2. Projektet e fituara dhe në zbatim gjatë vitit 2024/2025 .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>3. Projektet e aplikuar gjatë vitit akademik 2023-2024 .....</b>	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>e. STUDENTËT .....</b>	<b>68</b>
<b>f. BASHKËPUNIMI DHE KOMUNIKIMI ME MASR.....</b>	<b>74</b>
<b>B. Raporti i Bordit të Administrimit .....</b>	<b>75</b>

## HYRJE

Raporti vjetor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH) për vitin akademik 2024/2025 është përgatitur nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i institucionit dhe është strukturuar sipas çështjeve të listuara, fushave dhe kompetencës.

Ky raport është në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhëzimit Nr. 5, datë 19.2.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Raportimi synon të paraqesë informacione të qarta dhe transparente të veprimtarisë së UMSH-së në zbatim të misionit të tij dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Ky raport ofron informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit; mbi gjendjen financiare të UMSH-së, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifatat e shkollimit për vitin 2024/2025, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që UMSH-ja ofron.

Analiza e bërë në këtë raportim vjetor do të nxitë dhe të rritë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron UMSH-ja, gjithashtu do të paraqesë problemet e konstatuara gjatë vitit akademik 2024/2025, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.

Të dhënat e këtij raporti janë miratuar në mbledhjen e Senatit Akademik dhe atë të Bordit të Administrimit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

## A. Raportimi i Senatit Akademik

### a. REALIZIMI I QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE SIPAS PLANIT STRATEGJIK TË INSTITUCIONIT

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” ka filluar aktivitetin në vitin 2009. Me Urdhër Nr.82 datë 05.05.2021 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë është miratuar transferimi i aktivitetit të subjekti juridik privat “Mesdheu Education” shpk. Ky universitet zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë. Ai është themeluar nga një grup intelektualësh, profesorësh dhe ekspertësh me eksperiencë të gjatë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor.

Gjatë vitit akademik 2024/2025 ka funksionuar si Universitet, në bazë të Urdhërit Nr. 273 datë 18.05.2017 të MASR për miratimin e ristrukturimit dhe përbëhet nga katër njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Informatikës, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Këto njësi kryesore janë hapur/riorganizuar si më poshtë, në bazë të:

- VKM Nr. 177 datë 19.02.2009 të KM është miratuar hapja e njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Ekonomike;
- Urdhërit Nr.261 datë 12.05.2022 të MAS është miratuar hapja e njësisë kryesore Fakulteti i Informatikës;
- Urdhërit Nr.268 datë 16.05.2022 të MAS është miratuar riorganizimi i njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane;
- Urdhërit Nr.111 datë 27.02.2023 të MAS është miratuar hapja e njësisë kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike, që prej krijimit të tij, ofron programet e studimit në Ciklin e Parë "Bachelor" në Shkenca Ekonomike me profile: Financë Bankë dhe Kontabilitet, Administrim Biznesi, Biznes dhe Ligj, programe të Studimit në Ciklin e Dytë dhe programe profesionale. Gjatë ristrukturimit e zgjerimit të tij, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës për profesionistë dhe në ndjekje të trendit të zhvillimeve të teknologjisë së informacionit me ndikim në të gjithë ekonominë, Fakulteti i Shkencave Ekonomike ka shtuar e riorganizuar programet master dhe aktualisht ofron programet "Master i Shkencave" në Financë Bankë me profile (1) Banka dhe Tregje Financiare dhe (2) Teknologjitë e reja Financiare; "Master i Shkencave" në Administrim Biznesi me dy profile: (1) Sipërmarrja & Inovacioni dhe (2) Marketing Shitje & Komunikim; Master Profesional "Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar"; "Master Profesional" në Menaxhim Biznesi me profile: Menaxhim Arsimit, Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme, Menaxhim Turizmi, Menaxhim Arti, Menaxhim Shëndeti si dhe programi profesional dy-vjecar "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit". Në FSHE organizohet edhe program i studimit i ciklit të tretë studime të Doktoraturës në Shkenca Ekonomike, duke nxitur më tej punën kërkimore në fusha të rëndësishme për ekonominë e vendit dhe duke mbështetur proceset e integritimit dhe ndërkombëtarizimit në të cilat është përfshirë universiteti.

Në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane ofrohen Programi i studimit i integruar i ciklit të dytë në Drejtësi me kohëzgjatje 5 (pesë) vite akademike me kohë të plotë, programet e studimit në Ciklin e Parë Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare, Studime Psikosociale, Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, Mësuesi për Arsimin Parafillor, Mësuesi për Arsimin Fillor dhe Shkenca Politike dhe Administrative me profil: (1) Administratë Publike, (2) Politikat e Integritimit dhe Qeverisje. Në Ciklin e Dytë ofrohen programet e studimit: Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare; Master i Shkencave në E Drejtë Publike; Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare; Master i Shkencave në Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit; Master i Shkencave në Psikologji me profil: (1) Psikologji Organizative, (2) Psikologji Komunitare, (3) Këshillim dhe Psikoterapi me Orientim Njohës Sjellor; si dhe Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: (1) Studime Europiane, (2) Studime Mesdhetare; Master Profesional në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: (1)

Administratë Publike, (2) Politika Sociale, (3) Qeverisje Vendore; Master Profesional Menaxhim dhe Hartim Projektesh si dhe Programin për formimin e vazhduar "Çertifikatë Për Formimin Psiko-Pedagogjik" i cili u zhvillua për here të pare gjatë vitit akademik 2024/2025.

Fakulteti i Informatikës është i organizuar në dy departamente dhe një qendër kerkimore përkatësisht Departamenti i Informatikës së Biznesit, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale. Në Fakultetin e Informatikës ofrohen programe studimi në të tre ciklet, gjithashtu edhe studime profesionale: Diplomë profesionale në Teknologji Informacioni & Aplikime Informatike me profile (1) Specialist Rrjetash Kompjuterike, (2) Teknik për Pajisje Elektronike, (3) Teknik për Software dhe Dixhitalizim; Bachelor në Informatikë me profile: (1) Informatikë Biznesi, (2) Inxhinieri Informatike, (3) Teknologji Informacioni; Master Profesional në "Sistemet e Informacionit në Biznes", Master i Shkencave në Informatikë me profile: (1) Sistemet e Informacionit në Biznes, (2) Inxhinieri Software dhe studime të ciklit të tretë.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është i organizuar në tre departamente përkatësisht Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore dhe Departamenti i Teknologjive Mjekësore misioni i të cilëve është përgatitja e specialistëve të aftë për sektorin e shëndetësisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar përkatësisht në programet Bsc në Infermieri e Përgjithshme, Bsc në Teknik Laboratori dhe Bsc në Fizioterapi. Në këtë Fakultet synohet të ofrohet një arsim i lartë cilësor, duke integruar mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale. Fakulteti është i pajisur me laboratorë modernë dhe ofron mundësi bashkëpunimi për praktika profesionale jashtë vendit, si në Gjermani, përmes marrëveshjeve me institucione ndërkombëtare

UMSH ka si prioritet ofrimin e një mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Për këtë, synohet ndërtimi i kurrikulave në përputhje me eksperiencën më të mirë të universiteteve perëndimore, kërkesave të "Kartës së Bolonjës" dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet socio-ekonomike dhe zhvillimet e tregut.

Vizioni i institucionit për shndërrimin në një universitet lider për zhvillimin dhe përhapjen e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër dhe burim ekselence në formimin akademik të studentëve, për

përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve të rinj, një qendër ekspertize dhe kërkimi të specializuar shkencor në fushën e studimeve shoqërore - politike, ekonomike e juridike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë, ka qenë forca shtytëse që UMSH është zhvilluar dhe riorganizuar përgjatë viteve. Statuti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, është hartuar në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe në zbatim të tij, janë hartuar dhe akte të tjera si: rregulloret institucionale, rregullore të njësive përbërëse (akademike dhe ato ndihmëse), të programeve të studimit, etj si dhe urdhëra dhe udhëzime të tjera të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucionit në tërësi si dhe të pjesëve përbërëse të tij.

Të gjitha këto akte të brendshme pasqyrojnë vizionin, strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe filozofinë e tij. UMSH është një institucion i arsimit të lartë i cili vepron në përputhje me strategjinë afatëgjatë dhe afatmesme, duke synuar përcaktimin e objektivave të qarta dhe të realizueshme. Qëllimi kryesor është pajisja e gjeneratave të reja të studentëve me dije të nivelit të lartë bashkëkohore, me aftësi për tu përshtatur në tregun e punës, me interesa thelbësore për të vijuar studimin dhe pasurimin e materialit shkencor në vijimësi dhe pa ndërpreje.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), edhe gjatë vitit akademik 2024/2025, ka ndërmarrë hapat e duhur në zbatim të strategjisë afatmesme “Strategjia e Mësimdhënies, Dijeve të Qëndrueshme, Bashkëpunimit dhe Kërkimit Shkencor (SMDBK)”, e cila përcaktoi politikat dhe prioritetet strategjike të institucionit për periudhën 2018–2023. Pas realizimit dhe vlerësimit të objektivave të kësaj strategjie, UMSH ka vijuar punën për hartimin dhe përmirësimin e kuadrit strategjik institucional, duke miratuar në shtator 2025 strategjinë e re të zhvillimit, në funksion të rritjes së cilësisë akademike, forcimit të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar. Në realizimin e strategjisë së zhvillimit pararendëse, një rol të rëndësishëm ka kontributi i personelit akademik, administrativ dhe të studentëve të UMSH dhe vlerat e krijuara në vite të institucionit:

- Përvoja e krijuar që nga viti 2009, si një institucion i cili ka siguruar një standard të lartë cilësie, në një treg jo mirë të rregulluar të arsimit të lartë jopublik;
- Eksperienca të mira edhe të aktorëve të tjerë cilësorë në tregun e arsimit të lartë kombëtar;

- Eksperienca e institucioneve arsimore më të përparuara të rajonit dhe më gjerë nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimit;
- Vizioni dhe ambicia për ta shndërruar UMSH në një faktor të rëndësishëm të arsimit jopublik në vend, përmes investimit të vazhdueshëm në infrastrukturë, teknologji, cilësinë e personelit akademik, administrativ, ndërkombëtarizimit, etj;

Në realizimin e objektivave të zhvillimit të institucionit në përgjithësi dhe ato të vitit akademik 2024/2025 në veçanti, UMSH është udhëhequr bazuar në disa parime që kanë të bëjnë me: përmirësime të mëtejshme të menaxhimit të UMSH-së, ndryshime për përmirësim në mekanizmat e sigurimit të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme, ruajtjen pa kompromise të drejtësisë dhe integritetit, mbajtjen e identitetit institucional, adoptimin e një udhëheqjeje pjesëmarrëse, transparente, të orientuar tek vendimet, e ndjeshme, të shpejta dhe efektive; ndërveprimin aktiv me komunitetin, modelin e nxënies dhe kërkimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar, insitucionin e fokusuar tek studenti në çdo procedurë, dhënien rëndësi të harmonisë, lirisë dhe kënaqësisë së personelit; i hapur ndaj risive në ndjekje të ekselencës, dhe krijimin e një mjedisi akademik të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Në UMSH, mësimdhënia dhe mësimnxënia mbeten funksioni qendror në raport me studentët. Ky qëllim do të arrihet duke vlerësuar dhe mbështetur risitë në metodat e mësimdhënies dhe duke promovuar kontributet e secilit pedagog në lidhje me to në shkallë universiteti, por edhe në nivel kombëtar.

UMSH është përpjekur vazhdimisht të zhvillojë metoda moderne të mësimdhënies duke adoptuar qasje praktike të rastit në vend të mësimdhënies teorike dhe të papërpunuar, dhe duke dhënë mësim në grupe të vogla interaktive në klasë dhe jo në auditorë të mëdhenj, me bindjen e plotë se në këtë mënyrë mbështet më mirë zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të të diplomuarve në linjë me tendecat dhe nevojat e tregut të punës, dhe më e rëndësishmja përgatitja e tyre për të përballuar sfidat e "smart growth", parashikuar në të gjithë dokumentet kryesore që përcaktojnë objektivat në këtë sferë në vend si dhe ato mbizotërues në BE për të përhapur rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirje në punë.

Në vitet në vijim prioritet mbetet reforma kurrikulare. UMSH ndeshet me dy sfida në reformën e kurrikulës: rishikimi i kurrikulave egzistuese dhe lançimi i kurrikulave të reja, që të dyja janë të përshtatshme për një grup të ngjashëm zgjidhjesh.

Kështu, duhet bërë e qartë, nevoja për të racionalizuar ofertën kurrikulare në shkallë Universiteti, kjo në përputhshmëri me kriteret dhe ofertën akademike për çdo cikël studimi si risija e kurrikulës, mos përsëritja dhe dublikimi, dhe në përputhshmëri me tregun e punës. Gjithashtu reforma kurrikulare, përveçse do mundësojë shumëllojshmërinë e ofertës së studimit në cikle të ndryshme, duhet të krijojë frymëmarrje akademike brenda të njëtit cikël studimi, mundësi *cross curricular* (lëvizja nga një fakultet në tjetrin apo dhe nga një program në një tjetër brenda ciklit) dhe do të favorizojë mobilitetin dhe ekuivalentimin e studentëve. Kështu mundësohet një ekuilibër mes gjerësisë dhe thellësisë së studimeve, fleksibilitet i mjaftueshëm kurrikular dhe lehtësohet zgjedhja/përcaktimi i fushës së studimit nga studentët

Rritja e nivelit të mësimdhënies në UMSH nuk është thjesht çështje numrash; ajo kushtëzohet në radhë të parë prej faktit se janë më të shumtët ata pedagogë që operojnë me metoda që zhvillojnë tek studentët ato shprehuri dhe kompetenca, që u duhen atyre për të ardhmen.

Ndryshimi i stilit dhe metodave të mësimdhënies kërkon një investim madhor në zhvillimin e personelit akademik egzistues, duke përfshirë, pedagogët me eksperincë dhe domosdoshmërisht edhe trajnimin e personelit të ri. Për disa nga personeli ekzistues, është nevojitur një investim më vete, që është edhe më i kushtueshëm, por duke e konsideruar zhvillimin e burimeve njerëzore si një prioritet të lartë, atij i është kushtuar një mbështetje e veçantë financiare.

Pjesë e rëndësishme e strategjisë së zhvillimit janë edhe konceptimet e ndryshme të ngarkesës së pedagogut që kanë ndikime të rëndësishme mbi kriteret e punësimit të personelit akademik dhe të progresit në karrierë. UMSH ka përcaktuar kriteret e punësimit dhe të karrierës akademike, duke pranuar parimin që ato duhet të jenë fleksibël në varësi të misionit të tij. Kjo përfshin konceptim dhe zhvillim modelesh të ndryshme për ngarkesën e personelit akademik, parimet e të cilave mund të përfshihen në termat e punësimit të tij. Këto terma punësimi kanë përfshirë gjithashtu referenca lidhur me përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Si pjesë e marrëveshjes me personelin, që

ka realizuar këto përmirësime, janë parashikuar edhe forma nxitjeje financiare. Në këtë mënyrë, pagat kanë përfshirë një komponent, të lidhur me performancën. Pas përcaktimit të kriterëve të qarta, UMSH ka qenë i përgjegjshëm për të operuar me to në mënyrë plotësisht transparente.

Të rinjtë janë aseti më i vlefshëm që një vend ka për zhvillimin e tij të qëndrueshëm sa i përket produktivitetit ekonomik dhe avancimit social. Në këtë kontekst, për UMSH ka qenë me rëndësi parësore që një theks i veçantë të vihet në angazhimin gjithëpërfshirës të këtij brezi në tregun e punës.

Modelet aktuale të tranzicionit të tregut të punës të të diplomuarve janë komplekse dhe reflektojnë edhe tranzicionin socio-ekonomik të Shqipërisë. Të rinjtë lëvizin shpesh brenda dhe jashtë forcës së punës, ato fillojnë kryesisht në vende punë me kualifikim të ulët, të cilat shpesh nuk kanë lidhje me fushat e studimit dhe kualifikimin në universitet. Probleme të ngjashme të kësaj natyre janë vërejtur gjatë gjurmimeve periodike të bërë nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentëve në bashkëpunim me njësitë bazë, të cilët realizojnë në vazhdimësi analiza të tregut, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara, stafin mësimdhënës dhe specialistët e fushave përkatëse në formën e Boredeve të Punës të cilat funksionojnë në çdo Fakultet, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe synimet e zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

UMSH ka bërë përparim të konsiderueshëm në trajtimin e çështjes së hendekut midis aftësive së të diplomave dhe nevojave të tregut të punës, një mospërputhje kjo e e pergjitheshme e theksuar edhe në raporte të ndryshme të financuara nga partnerë dhe donatorë. Trajtimi i tillë është arritur përmes politikave dhe praktikave koherente dhe të bashkërenduara arsimore që në të njëjtën kohë adresojnë dhe koordinojnë aftësitë e diplomave me nevojat e tregut të punës në përputhje me “Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030” dhe me “Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026” në Shqipëri.

UMSH ka inkurajuar vazhdimisht rritjen e niveleve të bashkëpunimit midis nivelit akademik dhe palëve të tjera të interesit (punëdhënësit e ardhshëm, alumni, profesionistët, biznesi) në lidhje me hartimin e programeve dhe rishikimin periodik të kurrikulave dhe materialeve mësimore në mënyrë që të ndjekin tendencat aktuale të hulumtimit të menaxhimit dhe nevojat e tregut të punës.

Në këtë mënyrë besohet se një bashkëpunim i tillë do të përmirësojë përputhjen e të diplomuarve në fushën e kërkimeve dhe nevojave konkrete të tregut të punës.

UMSH është i përkushtuar që të zhvillojë një trupë akademike të përbërë nga pedagogë kërkues, studentë që bashkëpunojnë me pedagogët në projekte kërkimi, dhe punonjës, të cilët janë të përkushtuar për të përparuar praktikën kërkimore dhe profesionale në fushën e tyre. Gjatë vitit akademik 2024/2025 Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në të gjitha fakultetet e veta i dha një rëndësi të veçantë punës shkencore. Objektivat kryesore të kërkimit shkencor gjatë kësaj periudhe dhe objektivave afatshkurtër janë realizuar me hapjen e programeve të ciklit të tretë doktoratë në shkencat ekonomike dhe informatikës, të harmonizuara edhe me stadet paraprake të objektivave afatgjatë në përputhje me strategjinë e përgjithshme të institucionit.

Krijimi i mundësive për bashkëpunim në kërkimin shkencor si dhe në aktivitete të tjera krijuese është fokusuar në: **Krijimi i strukturave piramidale të kërkimit sipas fushave të tematikës shkencore** me në krye pedagogët drejtues të grupeve kërkimore shkencore të shquar të fushës, ku bëjnë pjesë gjithashtu pedagogë që kërkojnë në të njëjtën fushë si dhe pedagogë që udhëheqin mikroteza dhe disertacione në po atë fushë, me qëllim integrimin e kontributeve të kërkimit në drejtimet e paracaktuar të kërkimit në UMSH dhe fuqizimin e rezultateve.

Po kështu është punuar për **nxitjen e projekteve ndërdisiplinore të kërkimit**, si një mundësi për bashkëpunim në kërkim midis pedagogëve të fakulteteve të ndryshme, por duke zhvilluar kështu një mekanizëm për të gjetur pikat e përbashkëta midis interesave kërkimorë të pedagogëve dhe studentëve; krijimi i kushteve të përshtatshme logjistike për zhvillimin e aktivitetit akademik dhe të kërkimit shkencor; shpërndarja e rregullt e informacionit mbi mbështetjen institucionale për aktivitetin akademik dhe kërkimin shkencor tek studentët dhe pedagogët; Krijimi i hapësirave për aktivitete krijuese të pedagogëve, studentëve, si dhe grupimeve të tyre, dhe krijimi i mundësive për financimin e tyre; investime në tituj të rinj në bibliotekën e UMSH-së si dhe investim për teknologjinë e informacionit në shërbim të edukimit. Biblioteka e UMSH ofron akses për studentët e pedagogët në të gjithë programet e studimit përmes Bibliotekave Digjitale dhe fondit të “UMSH E-Library”.



Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gjatë vitit akademik 2024/2025, pasuroi bibliotekën e vet me literaturë bashkëkohore të fushave të ndryshme me rreth me një numër mbi 6000 tituj, të gjitha këto në funksion të programeve të studimit të organizuara sipas fakulteteve. Në bibliotekë ka: literaturë, botime periodike, si dhe një librari elektronike me një numër të konsiderueshëm titujsh, shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës., të aksesueshëm nga studentet dhe stafi akademik. Lista e librave të cilat plotësojnë kushtet e kërkimit shfaqen në ndërfaqje dhe mund të aksesohen në formatin PDF vetëm nga studentët dhe stafi akademik, të cilët kanë një user aktiv nëpërmjet adresës zyrtare të email-it të Universitetit. Biblioteka elektronike është pasuruar edhe me punimet shkencore dhe leksionet e pedagogëve të cilat gjithashtu janë të aksesueshëm nëpërmjet kësaj ndërfaqje. Ngritja e një ndërfaqje në funksion të menaxhimit të librave, revistave, monografive etj, ka sjellë një tërësi avantazhesh si menaxhim efikas i librave, monitorim më i mirë, shpejtesi në aksesim, dhe cdo veprim realizohet në kohë reale. Ky sistem ka vendosur Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë në pararojë të zhvillimeve në këtë drejtim dhe në synimet e shpejta ka si objektiv zhvillimin e tij nëpërmjet funksionaliteteve të tjera në funksion të menaxhimit të literatures së Universitetit, por gjithashtu edhe duke bashkëpunuar me Universitetet jashtë por edhe brënda vendit, pikërisht për të realizuar ndërtimin e infrastrukturës së duhur. Gjatë vitit akademik 2024/2025, përveç botimit të radhës të revistës EUROMEDITERRANEAN, që është botim periodik i UMSH që prej 14 vitesh, u botuan edhe numrat vijues të 2 periodikëve të rinj POLITEA dhe EKOINFOSYSTEM.

UMSH ka ndërtuar strategjinë e partneriteteve, e lidhur ngushtë me projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkimin shkencor, dhe aktorët e tregut të punës. UMSH synon ta zhvillojë më tej atë nëpërmjet hapjes dhe bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit në gjithë aktivitetin e tij akademik, mësimor, kërkimor e botues. Në themel të këtij bashkëpunimi qëndrojnë aktivitetet dhe produktet akademike e botuese të përbashkëta, shkëmbimi reciprok i eksperiencave dhe arritjeve në fushën mësimore, kërkimore, divulgative e botuese, realizimi i mobilitetit të studentëve e pedagogëve, etj. Prioritet i veçantë i jepet bashkëpunimit me universitetet, me qendrat e institutet kërkimore-shkencore dhe me institucione të tjera, me natyrë arsimore e pedagogjike, të vendit, të vendeve të rajonit, të atyre të Bashkimit Europian, të SHBA-së, dhe të Kanadasë, etj.

Zgjedhja dhe përcaktimi i linjave kryesore, i partnerëve dhe i produkteve themelore të bashkëpunimit me universitetet e tjera bëhet në përputhje të plotë me strategjinë dhe objektivat më të rëndësishme të zhvillimit të UMSH-s, filozofisë dhe vizionit të tij zhvillues në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe aktivitetit botues të tij. Nga ana tjetër, çdo rezultat pozitiv dhe arritje që vjen si pasojë e bashkëpunimit të suksesshëm kombëtar dhe atij ndërkombëtar konsolidohet dhe kapitalizohet në aktivitetin e përditshëm dhe në filozofinë e punës së institucionit.

Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin e Biznesit është shumë i rëndësishëm për UMSH në drejtim të ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe sigurimit të mbështetjes financiare në aktivitetet e ndryshme. Rasti i organizimeve të përbashkëta për promovimin e studentëve ekselentë dhe të krijimit të oportunitetve të stafit dhe studentëve për studime, punësim e shkëmbime të ndërsjellta është prioritet në të përditshmen e UMSH.

Duke zgjeruar aksesin dhe mundësitë për studime, UMSH kërkon që të regjistrojë dhe të vazhdojnë në mënyrë të suksesshme studimet një numër sa më i madh studentësh dhe nga prejardhje të ndryshme sociale, ekonomike, kulturore, etnike dhe fetare. UMSH gjatë vitit akademik 2024/2025 është përkushtuar për ta bërë më të gjallë eksperiencën e edukimit në universitet për studentët, duke regjistruar një trupë studentore më të madhe në numër dhe me diversitet, duke i krijuar mundësi studentëve që të arsimohen në një mjedis interaktiv dhe të larmishëm. Për më tepër, korpusi i UMSH është në një sipërfaqe të konsiderueshme dhe godina bashkohore që ndodhen brenda qytetit të Tiranës dhe përmban një infrastrukturë bashkëkohore edhe nga ana e teknologjisë duke ofruar facilitete me cilësi të lartë për studentët, stafin dhe për pjesëtarët e tjerë.

Në realizim të misionit të tij, UMSH ka qenë i fokusuar dhe do të vazhdojë të përqendrohet edhe në të ardhmen në disa shtylla kryesore si:

- Modernizimin në organizimin e institucionit dhe ofrimin e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës
- Rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe proceseve të mësim nxënies si dhe nxitjes së kërkimit shkencor afatgjatë, të mësuarit gjatë gjithë jetës

- Dhënia përparësi kërkimit shkencor, me fokus të veçantë në kërkimet ekonomike, sociologjike, antropologjike, juridike dhe të edukimit dhe zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shërbim të nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit të vendit;
- Sigurimi i cilësisë akademike;
- Përfaqja e programeve me kuadrin kombëtar të kualifikimit
- Rritja e investimeve dhe burimeve financiare për mësimdhënien, për inovacionin dhe punën kërkimore shkencore;
- Përgjegjësia sociale, rritja e përgjegjësisë së UMSH-it në shërbim të kohezionit social, në ndihmë të grupeve të popullsisë në nevojë dhe cilësisë së jetës së popullsisë së vendit.

UMSH mban në konsideratë dhe ka përcaktuar si objektiv kryesor ndjekjen e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe AI (njohur si Artificial Intelligence) dhe përfshirjen e tyre në planet e reja të zhvillimit institucional e të programeve të studimit. Për këtë qëllim gjatë vitit 2024/2025 u punua për hartimin e një platforme pune për futjen në procesin mësimor dhe kërkimor të AI (inteligjencës artificiale). Ky material i bashkëngjitet në mënyrë organike strategjisë së zhvillimit të UMSH, që u hartua nga autoritetet përgjegjëse.

## **b. MËSIMDHËNIA**

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” në vitin akademik 2024/2025 është përbërë nga katër fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Ekonomike,
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane
- Fakulteti i Informatikës
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore

dhe njësitë e tyre bazë të cilat organizojnë<sup>1</sup>: Studime të natyrës profesionale, Studime të Ciklit të Parë "Bachelor", Studime të Integruara të Ciklit të Dytë Master i Shkencave dhe të Ciklit të dytë

---

<sup>1</sup> Shiko Tabela 1 “TABELA ME TË DHËNA PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT” në vijim.

“Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” dhe Programet e Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë si dhe Programin për formimin e vazhduar.

Në funksion të përmirësimit të komunikimit të studentëve dhe pedagogëve, si dhe ndërmjet stafit akademik e atij ndihmës, edhe gjatë vitit akademik 2024/2025 institucioni investoi sërish në ndërtimin dhe aktivizimin e sistemeve të reja të komunikimit, që u përdorën me sukses në procesin mësimor, në atë organizativ dhe në aktivitetin shkencor. Edhe gjatë këtij viti akademik, krahas aktivitetit mësimor e këshillimor të zhvilluar në katedër, u aplikua gjerësisht edhe komunikimi online nëpërmjet G-Suite dhe sistemi Zoom Cloud meeting, ku u zhvillohen cikle diskutimesh problemore (Webinar UMSH Forum), konsultime të ndryshme si dhe një cikle trajnimesh për personelin e UMSH.

UMSH gjatë vitit akademik 2024/2025 ka organizuar programe studimi në tre cikle me këto tipare kryesore:

- *Programe studimi të natyrës profesionale, synojne që të :*
  1. Pajisin studentët me njohuri e koncepte bazë;
  2. Mundësojnë përvetësimin e dijeve dhe kulturës së nevojshme në fusha të caktuara;
  3. Pajisin studentët me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesione;
  4. Garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimit të vazhdueshëm profesional të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.
  5. Përfundojnë me Provim formimi.
  
- *Programe studimi në ciklin e parë “Bachelor”, synojne që të :*
  1. Pajisin studentët me njohuri e koncepte bazë;
  2. Aftësojnë studentët drejt një profesioni të thjeshtë, maksimalisht drejt një licence profesionale;
  3. Mundësojnë pajisjen me një diplomë të mundshme profesionale;

4. Sigurojnë një formim qytetar të përgjithshëm;
  5. Pajisin studentët me aftësi bazë për punë kërkimore;
  6. Pajisin studentët me aftësi të përgjithshme aplikative;
  7. Aftësojnë studentët për promovim personal;
  8. Përfundojnë me Provim formimi, që dëshmon si është kuptuar puna e studiuësve të tjerë në fushën përkatëse.
- *Programe studimi në ciklin e dytë “Master i Shkencave”, dhe “Master profesional” synojnë që të:*
    1. Pajisin studentët me koncepte të thella, të zgjeruara dhe të specializuara;
    2. Mundësojnë formime tematike, jo panoramike dhe historike;
    3. Aftësojnë studentët për kërkim të pavarur, të avancuar shkencor;
    4. Parapërgatitin studentët për licencë profesionale, duke përfshirë dhe trupëzuar plotësisht në program kërkesat e profesioneve të rregulluara;
    5. Aftësojnë plotësisht studentët për zhvillim karriere;
    6. Mundësojnë kryerjen e praktikave mësimore në kompanitë, punëdhënësit më të mëdhenj;
    7. Aftësojnë plotësisht studentët dhe i motivojnë ata nga ana intelektuale për të vijuar studimet në doktoraturë;
    8. Përfundojnë me Punim Diplomë që është punim me origjinalitet, me karakter teorik e empirik, produkt krijues i studentit dhe Provim formimi, që dëshmon si është kuptuar puna e studiuësve të tjerë në fushën përkatëse.
  - *Programe studimi në ciklin e tretë Tretë Doktoratë synojnë që të zhvillojnë:*
    1. Të menduarit krijues;
    2. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;
    3. Lidhjet mes fushave të ndryshme paralele të kërkimit dhe fushës së tij;
    4. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
    5. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit;

- *Programet e formimit të vazhduar synojnë që të:*
  1. Mundësojnë përditësimin dhe thellimin e njohurive profesionale dhe akademike në fusha të ndryshme, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore;
  2. Pajisin pjesëmarrësit me kompetenca praktike dhe aplikative për rritjen e performancës në vendin e punës;
  3. Mbështesin zhvillimin e aftësive të reja (upskilling/reskilling) në funksion të kërkesave të tregut të punës dhe transformimeve teknologjike;
  4. Ofrojnë specializim të vazhdueshëm profesional, duke integruar praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat përkatëse;
  5. Nxisin kulturën e të mësuarit gjatë gjithë jetës (lifelong learning) dhe promovojnë pjesëmarrjen aktive në formime të vazhdueshme;

Tabela e mëposhtme (Tabela 1) paraqet programet e studimit të organizuara në të gjitha njësitë akademike të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë:

*Tabela 1.*

FAKULTETI	DEPARTAMENTI	PROGRAMI
Fakulteti i Shkencave Ekonomike	DEPARTAMENTI I FINANCË, BANKË DHE KONTABILITETIT	Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Financë, Bankë dhe Kontabilitet
		Master i Shkencave në Financë Bankë me profil: Banka dhe Tregje Financiare
		Master i Shkencave në Financë Bankë me profil: Teknologjitë e Reja Financiare
		Master Profesional në Auditimi i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar
	DEPARTAMENTI I MENAXHIM DHE MARKETING	Program i ciklit të tretë Studime të Doktoratës
		Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Administrim Biznesi
		Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Sipërmarrja dhe Inovacioni
		Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Shëndeti
		Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Shëndeti
		Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Shëndeti
		Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme
		Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Turizmi
		Diplomë Profesionale në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit
		Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Marketing, Shitje dhe Komunikim
	DEPARTAMENTI I EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Arsimi
Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Arti		
Fakulteti i Informatikës	DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS SE BIZNESIT	Program i ciklit të tretë Studime të Doktoratës
		Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Biznes dhe Ligj
		Program i ciklit të tretë Studime të Doktoratës
	DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS SE BIZNESIT	Bachelor në Informatikë me profil Informatikë Biznesi
		Master i Shkencave në Informatikë me profil: Sistemet e Informacionit në Biznes
		Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes
		Bachelor në Informatikë me profil Inxhinieri Informatike
		Bachelor në Informatikë me profil Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
		Master i Shkencave në Informatikë me profil: Inxhinieri Softwar
		Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Specialist Rrjetash Kompjuterike
		Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajisje Elektronike
	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJISË SE INFORMACIONIT	Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajisje Elektronike
		Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajisje Elektronike
		Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajisje Elektronike
		Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Software dhe Dixhitalizim
QENDRA E INOVACIONIT DHE TEKNOLOGJIVE DIGJITALE	Program i ciklit të tretë Studime të Doktoratës	
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane	DEPARTAMENTI I SË DREJTËS	Master i Shkencave në E Drejtë Publike
		Program studimi i integruar në Drejtësi
		Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare
	DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDERKOMBËTARE	Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare
		Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil: Politikat e Integritit dhe Qeverisje
		Bachelor në Shkenca Politike me profil: Administratë Publike
		Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare
		Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime mesdhetare
		Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime evropiane
		Master i Shkencave në Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit
		Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Politikat Sociale
		Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Qeverisje Vendore
		Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Administratë Publike
	DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË DHE SOCIOLOGJISË	Bachelor në Studime Psikosociale
		Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Organizative
		Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Komunitare
		Master i shkencave në Psikologji me profil: Këshillim dhe Psikoterapi me orientim Njohës Sjellor
	DEPARTAMENTI I EDUKIMIT, KOMUNIKIMIT DHE FORMIMIT TË KOMPETENCAVE	Bachelor në Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun
		Bachelor në Mësuesi për Arsimin parashkollor
		Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor
Master Profesional Hartim dhe Menaxhim Projektsh		
Fakulteti i Shkencave Mjekësore	DEPARTAMENTI I INFERMIERISTIKËS	Bachelor në Infermier i Përgjithshëm
	DEPARTAMENTI I SISTEMEVE DIGJITALE MJEKËSORE	Bachelor në Fizioterapi
	DEPARTAMENTI I TEKNOLOGJIVE MJEKËSORE	Bachelor në Teknik Laboratori

- *Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit dhe me tregun e punës*

Gjatë vitit akademik 2024/2025 është bërë e qartë nevoja për të racionalizuar ofertën kurrikulare në shkallë Universiteti, kjo në përputhshmëri me kriteret dhe ofertën akademike për çdo cikël studimi si risija e kurrikulës, mos përsëritja dhe dublikimi, dhe në përputhshmëri me tregun e punës. Gjithashtu reforma kurrikulare, përveçse ka mundësuar shumëllojshmërinë e ofertës së studimit në cikle të ndryshme, ka krijuar frymëmarrje akademike brenda të njëtit cikël studimi, ka favorizuar mobilitetin dhe ekuivalentimin e studentëve. Kështu mundësohet një ekuilibër mes gjerësisë dhe thellësisë së studimeve, fleksibilitet i mjaftueshëm kurrikular dhe lehtësohet zgjedhja/përcaktimi i fushës së studimit nga studentët.

Për të arritur këtë gjatë vitit, nga ana e njësive akademike dhe ato ndihmëse, janë ngritur Grupe Pune për rishikim/përmirësim të kurrikulës, për të analizuar ofertën akademike të Universitetit. Të gjitha programet e studimit që organizohen nga njësitë përkatëse në UMSH, ishin objekt i ndryshimeve si në aspektin e përshtatjes me aktet e reja nënligjore, por me një theks të veçantë në përmirësimin e vazhdueshëm për të siguruar koherencën e programeve tona me tregun e punës në bazë departamenti dhe grup lënde. Kështu është arritur fuqizimi i komunikimit midis lëndëve të formimit të përgjithshëm, lëndëve praktike dhe lëndëve të profilit, me qëllim realizimin e një formimi Bachelor dhe Master të qëndrueshëm si dhe formimit në programet e natyrës profesionale.

Për formimin e shprehive si tipare të qëndrueshme të studentëve në tregun e punës vlen jo vetëm tërësia e njohurive nga cdo program studimi në UMSH, por dhe aftësitë e kompetencat që studentët zotërojnë në përmbyllje të tij, pra formimi i plotë dhe ndërshkencor i përfituar gjatë nivelit bachelor/Master, u ka krijuar atyre mundësitë për ndjekjen dhe vazhdimin e studimeve por mbi të gjitha afrimin me tregun e punës.

Përmes programeve të studimit në UMSH studentët aftësohen që të zotërojnë shprehje të tilla, të punës si:

- Aftësia për tu orientuar në situata, politika dinamike, problematike, komplekse dhe deri te ato konfliktuale;
- Fitojnë shprehi sesi mund të arsyetojnë në mënyrë të pavarur duke balafuar realitetet konkrete me ecurinë historike të problemeve nga më të ndryshmet;
- Ata kanë fituar shprehi të punës së pavaruar, duke përdorur metoda shkencore, na analizën e fakteve, dukurive, realiteteve politike, sociale dhe gjeopolitike me qëllim nxjerrjen e përfundimeve dhe rekomandimin e planit të veprimit në situatën konkrete;
- Kanë fituar shprehi për të hedhur të dhënat që rekomandon vëshgimi empirik si në plan horizontal ashtu edhe në plan të një vijëmsie kohore vertikale.
- Për studentët që profilizohen psh. në studimet për Administratë Publike, UMSH është kujdesur që ato të marrin si shprehi themelore të aftësimin, si më poshtë:
  - Në gjendje për të punuar në grup
  - Për të përballuar punën nën presion
  - Shprehi të dallueshme të tolerancës, mirekuptimit dhe mirëpritjes të ideve ndryshe
  - Aftësi të mira në komunikim
  - Shprehi të mbajtjes së ritmit të përshpejtuar

Puna në administratën publike nuk trajtohet thjesht si korrektesë sterile me rregullin por i vihet theksi ndërtimit të aftësive për komunikimin njerëzor si art.

UMSH ka promovuar gjithashtu formimin profilizues të studentëve që të jenë të aftë dhe të kenë kapacitet e nevojshme që të hynë në tregun e punës në të gjitha ato hapësira institucionale dhe ligjore, publike apo private apo edhe sipërmarrjes si një gjeneratë që manifeston gatishmërinë për t'u përballuar me sfidat dhe për të zgjidhur problemet që janë tashmë sfida të shoqërisë shqiptare. Universiteti ka krijuar mekanizma të studimit të tregut dhe është përpjekur të përshtasë kurrikulën me tregun e punësimit. Janë marrë herë pas here në konsideratë kërkesat e punëdhënësve nga aktorët potencialë të tregut të punësimit në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, sidomos me fokus rajonin Ballkanik/Mesdheun/Europën.

- *Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së*

Nuk ka ndryshime në Statutin e UMSH gjatë kësaj vitit akademik 2024/2025

- *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave*

1. NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT TË KURRIKULAVE

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është një strukturë e ngritur në nivel universiteti, e miratuar nga Rektori dhe që funksionon në përputhje me një rregullore të veçantë. Misioni i saj është të garantojë cilësinë e brendshme institucionale, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm akademik dhe të sigurojë që proceset mësimore, kërkimore dhe administrative të jenë në përputhje me standardet më të mira të arsimit të lartë. NJSBCZHK përbëhet nga 10 anëtarë: drejtuesja e njësisë, përfaqësues nga çdo departament të përzgjedhur mes pedagogëve, një përfaqësues nga administrata dhe një nga Këshilli Studentor.

Për vitin akademik 2024/2025, NJSBCZHK ka përcaktuar këto objektiva kryesore:

- Monitorimi dhe vlerësimi periodik i cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive administrative në të gjitha njësitë akademike;
- Hartimi dhe dorëzimi i raporteve të detajuara të vlerësimit për çdo departament dhe fakultet;
- Mbështetja e përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore në arsim;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së stafit akademik e administrativ në proceset e sigurimit të cilësisë;

Përgatitja dhe dorëzimi i raportit vjetor përpara Rektorit në fund të çdo viti akademik.

## 2. AKTIVITETET KRYESORE TË NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT TË KURRIKULAVE (NJSBCZHK) GJATË VITIT AKADEMIK 2024/2025

### 1. Monitorimi i zbatimit të standardeve të cilësisë

Metodologjia e punës së NJSBCZHK është ndërtuar mbi bazën e Rregullores së njësisë, Manualit të saj të brendshëm, Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, si dhe dokumenteve udhëzuese të ASCAL.

Në fillim të vitit akademik, njësia paraqiti planveprimin 2024/2025, të miratuar nga Rektori dhe i ndërtuar në përputhje me politikat institucionale për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Gjatë gjithë vitit, NJSBCZHK ka monitoruar:

- Zbatimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe procese administrative;
- Marrëdhënien pedagog–student dhe departament–student;
- Dokumentacionin në njësitë bazë, duke verifikuar përmbajtjen dhe korrektësinë e të dhënave;
- Syllabuset e lëndëve dhe programet e studimit, në përputhje me standardet institucionale;
- Proceset e provimeve përfundimtare dhe dosjet e diplomave, duke siguruar përputhje me udhëzimet e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, Rektoratit dhe kërkesat akademike.

Për çdo proces është realizuar njoftim paraprak, monitorim në terren, raportim me shkrim dhe dorëzim i dokumentacionit përkatës tek Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë dhe Rektorat.

Në përfundim të vitit akademik, NJSBCZHK dorëzoi raportin vjetor të njësisë dhe dosjen e plotë të vlerësimeve, duke përfshirë të gjitha monitorimet dhe rezultatet e tyre.

### 2. Organizimi i vlerësimeve të brendshme dhe sondazheve

Në zbatim të planveprimit, njësia ka organizuar një sërë vlerësimesh të brendshme dhe sondazhe:

- Vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët, i zhvilluar në fund të çdo semestri, si në mënyrë online ashtu edhe në auditor, nën mbikëqyrjen e anëtarëve të NJSBCZHK. Studentët u

informuan për rëndësinë e procesit përmes tutorëve akademikë dhe komunikimeve të drejtpërdrejta në klasë.

- Focus Group-et me studentë të niveleve BSc, MSc dhe Doktoraturë, të zhvilluara në të dy semestrat me qëllim mbledhjen e reagimeve cilësore për përvojën akademike, respektimin e standardeve dhe komunikimin pedagog–student.
- Takime periodike me Këshillin Studentor, për të marrë opinione, vlerësime dhe sugjerime mbi cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin universitar. Këto takime janë dokumentuar me procesverbale të posaçme.

Gjithashtu, për çdo proces vlerësimi është përdorur një model i unifikuar raporti, i shpërndarë paraprakisht tek të gjithë anëtarët e njësisë, për të siguruar standardizim dhe krahasueshmëri në analizën e të dhënave.

### 3. Trajnimet e stafit dhe aktivitetet për përmirësimin e cilësisë

NJSBCZHK ka ndjekur parimin e përmirësimit të vazhdueshëm, duke ndërmarrë këto veprimtari për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ:

- Organizimi i takimeve paraprake dhe konsultimeve për mënyrat e vlerësimit dhe për përdorimin e instrumenteve të monitorimit;
- Trajtime të brendshme mbi standardet e cilësisë, hartimin e syllabuseve, si dhe mbi rëndësinë e feedback-ut të studentëve;
- Mbështetje teknike në menaxhimin e dokumentacionit akademik nëpërmjet mirëmbajtjes së sistemit “SHARE FOLDER”, ku janë depozituar materialet e nevojshme për përdorim nga stafi akademik e administrativ;
- Monitorimi semestral i pedagogëve dhe lëndëve, në bashkëpunim me drejtuesit e njësive bazë, me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies në kohë reale.

Këto veprimtari kanë kontribuar në forcimin e kulturës së cilësisë brenda institucionit dhe në rritjen e ndërgjegjësimit profesional të stafit për rolin që ka secili në ruajtjen e standardeve akademike.

### 4. Roli dhe kontributi i ekspertëve të jashtëm

Në përputhje me politikat e hapjes dhe krahasueshmërisë ndërinstitucionale, NJSBCZHK ka bashkëpunuar me ekspertë të jashtëm të cilësisë, të cilët kanë ofruar:

- Këshillim për harmonizimin e metodologjive të vlerësimit me udhëzimet e ASCAL dhe praktikatat europiane të sigurimit të cilësisë;

- Mbështetje në analizën e të dhënave të sondazheve dhe interpretimin e rezultateve për përmirësime të ardhshme;
- Sugjerime për përmirësimin e planifikimit strategjik dhe për përafrimin me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Këto bashkëpunime kanë forcuar integritetin profesional të proceseve vlerësuese dhe kanë ndihmuar institucionin të zhvillojë një model të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë, në përputhje me kërkesat e brendshme dhe ato kombëtare.

Të gjitha proceset e mësipërme janë të dokumentuara me datat dhe analizat përkatëse në dosjen e NJSBCZHK, të dorëzuar në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë dhe Rektorat dhe Rektorat.

### 3. PROCESI I ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS

#### 3.1. Analiza e nevojave

Procesi i zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulave në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH) është udhëhequr nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), me udhëzime të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet, dekanatet dhe strukturat e tjera mbështetëse akademike.

Vlerësimi i kërkesave të tregut të punës dhe feedback-ut nga studentët, stafi dhe palët e interesuara Në kuadër të këtij procesi, gjatë vitit akademik 2024/2025, NJSBCZHK ka mbledhur dhe analizuar të dhëna nga disa burime:

- Sondazhet e studentëve mbi përmbajtjen e lëndëve, përputhjen e tyre me nevojat profesionale dhe nivelin e praktikave të ofruara;
- Focus group-et me studentë të cikleve BSc, MSc dhe Doktoraturë, të cilat kanë ofruar informacion të vlefshëm mbi mënyrën e zhvillimit të lëndëve, ngarkesën mësimore dhe mbështetjen akademike;
- Takimet me përfaqësues të Këshillit Studentor dhe stafin pedagogjik, për të identifikuar aspekte të përmirësueshme në strukturën e programeve;

- Konsultimet me përfaqësues të tregut të punës dhe ekspertë të jashtëm, që kanë ndihmuar në vlerësimin e përputhshmërisë së njohurive të ofruara me kompetencat e kërkuara në fushën profesionale përkatëse.

Identifikimi i boshllëqeve dhe mundësive për përmirësim.

Nga analiza e kryer janë identifikuar disa boshllëqe në kurrikula, që lidhen me:

- Nevojën për përditësim të literaturës dhe burimeve didaktike në disa lëndë;
- Rritjen e komponentit praktik dhe angazhimit me projekte konkrete që pasqyrojnë kërkesat e tregut të punës;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërdisiplinor në disa programe studimi;
- Përdorimin më të gjerë të platformave digjitale dhe metodologjive interaktive në procesin mësimor.

Në përfundim të procesit të analizës, janë hartuar rekomandime për përmirësim, të cilat janë përcjellë pranë njësive bazë dhe janë përfshirë në planin institucional të zhvillimit të kurrikulave për vitin pasardhës akademik.

### 3.2. Përputhja me standardet

Sigurimi i përshtatjes së programeve me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare

NJSBCZHK ka garantuar që procesi i zhvillimit të kurrikulave të përputhet plotësisht me:

- Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;
- Standardet e Akreditimit të përcaktuara nga ASCAL;
- Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), në përfrim me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEQF);
- Udhëzimet e ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education) dhe Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG).

Në kuadër të kësaj përputhjeje, NJSBCZHK ka zhvilluar takime periodike me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve për të siguruar që çdo ndryshim kurrikular të jetë në harmoni me kërkesat ligjore dhe praktikat ndërkombëtare.

Gjithashtu, janë integruar udhëzimet e reja të ASCAL për formatin e syllabusit, metodologjinë e vlerësimit të rezultateve të të nxënit dhe përafrimin e krediteve me sistemin ECTS.

Referenca ndaj akreditimeve ose udhëzimeve të reja ligjore

Gjatë vitit akademik 2024/2025, NJSBCZHK ka ndjekur proceset e akreditimit dhe vetëvlerësimit të disa programeve, duke reflektuar në kurrikula rekomandimet e ardhura nga raportet e jashtme të vlerësimit.

Përmes këtyre përditësimeve, UMSH ka siguruar që programet e studimit të jenë në përputhje me standardet kombëtare të cilësisë dhe të krahasueshme me institucionet homologe në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL).

#### 4. Rezultatet në Bashkëpunim me Njësitë Bazë (Viti Akademik 2024/2025)

Gjatë vitit akademik 2024/2025, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) ka realizuar një sërë veprimtarish në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë akademike dhe strukturat mbështetëse të universitetit. Këto veprimtari kanë synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, forcimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kurrikulave.

##### 1. Identifikimi i praktikave të mira dhe përmirësimeve të zbatuara

Në kuadër të bashkëpunimit me departamentet, janë evidentuar praktika të mira lidhur me respektimin e formatit të syllabuseve, i cili është ndjekur me rigorozitet nga një përqindje shumë e lartë e stafit akademik. Përmirësimet e zbatuara përfshijnë përdorimin më të gjerë të metodave interaktive të mësimdhënies dhe përfshirjen e platformave digjitale për lehtësimin e komunikimit me studentët. Rastet e nevojshme për ndërhyrje janë adresuar në mënyrë individuale, duke orientuar pedagogët drejt praktikave më bashkëkohore të zhvillimit të orëve të mësimi.

##### 2. Raportet e përgatitura dhe rekomandimet për departamentet

Për çdo monitorim të zhvilluar gjatë dy semestreve është hartuar raport vlerësimi nga anëtarët e NJSBCZHK dhe përgjegjësit e departamenteve përkatëse. Këto raporte përmbajnë vlerësimet mbi procesin mësimor, pjesëmarrjen e stafit, metodologjinë e përdorur dhe përfshirjen e studentëve. Të gjitha rekomandimet e dalë nga analizat janë përcjellë në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Rektorat dhe sipas rastit, në njësitë bazë për zbatim të mëtejshëm.

##### 3. Rezultatet nga vlerësimet e studentëve dhe stafit për cilësinë

Në javën e 13-të të çdo semestri, është realizuar procesi i vlerësimit të pedagogëve dhe lëndëve nga studentët për ciklet BSC dhe MSC, përmes linkut online anonim. Të dhënat janë përpunuar dhe raportet përfundimtare janë dorëzuar në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë dhe Rektorat. Rezultatet kanë treguar një nivel të lartë kënaqësie nga ana e studentëve, veçanërisht në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, qartësinë e materialeve dhe përkushtimin e stafit. Në raste të veçanta, janë dhënë udhëzime për përmirësim në drejtim të metodave interaktive të zhvillimit të orëve të mësimit.

#### 4. Programet e reja të krijuara ose ato ekzistuese të përmirësuara

Në kuadër të rishikimit të vazhdueshëm të programeve, NJSBCZHK ka bashkëpunuar me departamentet për të përafruar përmbajtjen e programeve ekzistuese me standardet kombëtare dhe kërkesat e tregut të punës. Përmirësimet janë fokusuar në strukturimin më të qartë të rezultateve të të nxënit, integrimin e aftësive praktike dhe zhvillimin e moduleve të reja që mbështesin formimin profesional të studentëve.

#### 5. Ndryshimet kryesore në struktura, përmbajtje apo lëndë

Si pjesë e përmirësimeve strukturore, është kryer ristrukturimi i SHARE FOLDER me UMSH, duke ndarë dokumentacionin në foldera të veçantë sipas funksionit dhe duke arkivuar materialet e mëparshme. Kjo ka lehtësuar ndjeshëm qasjen e pedagogëve, përgjegjësve të departamenteve dhe grupeve të punës për RVB ndaj dokumenteve të nevojshme (rregullore, formate, udhëzime, etj.). Përmbajtja e lëndëve është rishikuar në disa raste për të reflektuar zhvillimet e fundit akademike dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

#### 6. Përmirësimet në metodologjitë e mësimdhënies dhe vlerësimit

Në bashkëpunim me njësitë bazë, janë zhvilluar takime të rregullta me tutorët akademikë dhe Këshillin Studentor, me qëllim identifikimin e problematikave dhe propozimin e zgjidhjeve konkrete për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu, focus grupet për programet BSC, MSC dhe Doktoraturë, të zhvilluara në fund të çdo semestri, kanë shërbyer si mjet reflektimi mbi përvojën akademike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë.

Në programin e doktoraturës, është vënë theksi te cilësia e mentorimit dhe mbështetja nga udhëheqësit shkencorë, e cila është vlerësuar shumë pozitivisht nga doktorantët pjesëmarrës.

- *Parashikimi për angazhimin e personelit akademik*

Personeli akademik në UMSH ndahet në tre kategori, personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ. Personeli akademik dhe drejtuesit akademik kryejnë veprimtari të mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbime në zhvillim të institucionit, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative. Personeli akademik ndahet në personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Personeli akademik efektiv përbëhet nga drejtuesit dhe stafi akademik i brendshëm. Personeli akademik me kontratë përbëhet nga stafi akademik i jashtëm dhe lektorët e ftuar.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat ligjore në fuqi, me dispozitat përkatëse në Statutin e UMSH dhe me dokument të veçantë. Secili Departament pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në Fakultet, nga ku përcillet për miratim te Rektori e për veprim të mëtejshëm pas miratimit në ZBNJ. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritët të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm.

Lajmërimi bëhet në faqen zyrtare të web-it të UMSH dhe sipas nevojave edhe në të përditshmet shqiptare (gazetat apo platformat online).

Personeli akademik përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një komision i veçantë, të ngritur nga Rektori, ku marrin pjesë Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përfaqësues nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- a) Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;

- b) Të ketë së paku gradë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik; (Pranohen në raste specifike individë të ekselencës ose profesionistë të shquar edhe pa gradën Doktor)
- c) Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;
- d) Rezultatet personale të kandidatit;
- e) Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencore të UMSH;
- f) Motivet kryesore për t'u bërë pedagog në UMSH;
- g) Aftësitë komunikuese dhe etika;
- h) Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;
- i) Përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
- j) Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;
- k) Paraqitja gjatë intervistës nga komisioni i posaçëm i rekrutimit;
- l) Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës (kur aplikohet).

Përveç pedagogëve me tituj e grada, për nevoja të veçanta dhe për periudha të caktuara, në UMSH mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë unikë në fushën e tyre të specializimit. Marrja e tyre bëhet për të plotësuar kërkesa të veçanta të programit mësimor, të tilla si lëndë me karakter praktik, cikle specifike leksionesh dhe seminaresh, orësh praktike, etj.

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe UMSH, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UMSH, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UMSH.

Ngarkesa mësimore është e ndarë sipas normave mbi ngarkesën mësimore që duhet të ketë çdo pedagog. Shpërndarja e lëndëve në departament është bërë duke u bazuar në kualifikimin dhe fushën e studimit të pedagogëve me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Cilësia e realizimit të ngarkesës mësimore: Pavarësisht kriterit të zbatuar për ndarjen e lëndëve dhe të gjithë ngarkesës mësimore sipas profilit të pedagogëve, është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zbatimi i detyrimeve ligjore edhe realizimi konkret i procesit mësimor duke vlerësuar rast pas rasti cilësinë e mësimdhënies.

Metodat e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e angazhuar në të gjitha programet që organizohen në UMSH, janë të larmishme. Krahas zhvillimit të leksioneve në auditore si formë klasike e mësimdhënies janë përdorur edhe metoda si organizimi i diskutimeve, debateve me studentët, janë simuluar situata konkrete, janë krijuar grupe të vogla studentësh. Janë organizuar auditore të hapura organizuar me specialistë në fusha të ndryshme ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të studentëve.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohet edhe nëpërmjet ndjekjes së orëve mësimore nga drejtues të njësive. Janë marrë mendime, sugjerimi dhe vërejtje nga studentët për pedagogë të ndryshëm dhe lëndë të ndryshme dhe është diskutuar mbi mundësitë reale të zhvillimit të të gjithë procesit mësimor sipas standarteve që kërkohen. Nga kontrollet e bëra janë mbajtur shënime të sakta nga drejtuesit përkatës të njësive, të cilat më pas janë referuar në linjë hierarkike.

Në tabelat më poshtë (Tabelat 2, 3, 4 dhe 5) të dhënat mbi personelin akademik të angazhuar në vitin 2024/2025, sipas njësive, titujve dhe gradave dhe statusit të tyre në UMSH.

*Tabela.2 Personeli Fakulteti i Shkencave Ekonomike*

FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Adrian Civici	Prof.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Ina Shehu	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Eros Angjeli	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Eriola Hoxha	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Majlinda Shehu	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Nerajda Feruni	Msc	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Valter Hoxha	PHD	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Edit Bregu	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Rexhina Alite	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Vjola Loku	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Alkida Llanaj	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Nexhmi Dumani	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Anisa Bika	Msc	PAK
FSHE	Departamenti i Ekonomisë dhe Zhvillimit	Ferit Balla	Dr	PAK
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Anastas Angjeli	Prof.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Ardita Hykaj	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Armelina Lila	PHDc.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Elira Hoxha	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Elona Shehu	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Festim Kodra	Msc	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Kristal Hykaj	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Lindita Milo	Prof.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Orkida Ilollari	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Rudina Qurku	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Sonila Nikolla	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Vladimir Mici	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Enida Demiraj	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Ines Kocij	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Ama Musa	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Ina Balukja	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Eleana Lici	Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Hysen Çela	Prof.Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Ingrid Shuli	Prof.Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Najada Xhaxha	Msc	PAK
FSHE	Departamenti i Financë, Bankë dhe Kontabiliteti	Orfea Dhuci	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Ana Gorenca	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Aurora Sulçe	Msc	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Drita Avdyli	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Eni Nasi	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Ira Gjika	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Enrik Sejdinaj	Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Loris Hoxha	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Nikollaq Pano	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Rakela Zefi (Lazaj)	Msc	PAEK
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Ferjolt Ozuni	PHD	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Anisa Kadria	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Egra Ibrahim	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Ortis Hodaj	Drp.	PAE
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Dorjan Teliti	Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Eleina Qirici	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Liljana Elmazi	Prof. Dr.	PAK
FSHE	Departamenti i Menaxhim dhe Marketing	Mirela Mersini	Prof.Assoc.Dr.	PAK

Tabela.3 Personeli Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane

FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Aurora Daka	Drp.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Elton Skendaj	Drp.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Holta Heba	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Skender Demaliaj	Dr./Doc	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Valbona Lohja (Cangonja)	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Yljet Aliçka	Prof.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Zirina Llambro	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Ilda Kashami	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Morena Çitozi (Braçaj)	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Era Buçpapaj	Drp.	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Fatjona Toska	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Gejla Shehaj	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Adrian Gorencia	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Merita Baku	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave	Adi Krasta	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Arjan Çuri	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Arjeta Veshi	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Ela Tollkuçi	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Fleura Shkëmbi	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Inis Shkrelli	PHD	PAE - PAK
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Klodiana Rafti	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Mimoza Ahmeti	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Nora Malaj	Drp.	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Romina Çaushaj	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Valbona Treska	Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Marta Bej	Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Valbona Habili (Sauku)	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë	Destemona Çelo	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Aiketa Elezi	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Arben Prifti	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Besmir Alushi	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Besmir Premalaj	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Bujar Taho	PHDc.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Fiona Tako	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Erjola Allaj	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Indrit Shtupi	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Ksenofon Krisafi	Prof.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Luljeta Kodra	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Redion Luli	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Erina Caka	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Julian Çollaku	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Bledar Iljazi	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Artan Spahiu	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Elbana Lluri	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Sabri Hoxha	Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Irida Danaj	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Arjan Oafa	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Sokol Pina	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i së Drejtës	Jori Bregasi	Msc	PAK
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Arben Cici	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Dritan Hoti	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Emilio Çika	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Enkeleda Memisha	Drp.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Gilda Hoxha	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Ilir Allaj	Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Kriton Kuçi	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Nevila Rama	PHD	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Paskal Milo	Prof.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Roland Lami	Prof.Assoc.Dr.	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Klea Lleshi	Msc	PAE
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Edon Qesari	PHD	PAK
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Ilir Hebovija	Drp.	PAK
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Xhuljeta Krasta	Dr.	PAK
FDSHH	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare	Manushaqe Shehu	Dr.	PAK

*Tabela 4. Personeli Fakulteti i Informatikës*

FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Ajkuna Mujo	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Dhimitri Tole	Prof.Dr.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Elis Pelivani	PHD	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Eneida Hoxha	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Ergita Kaso	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Frida Zisko	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Luka Halili	Msc	PAE PNA
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Olgerta Idrizi	Dr.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Elion Shabanaj	Msc	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Gerild Qordja	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Informatikës së Biznesit	Kozeta Sevrani	Prof.Dr.	PAK
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Frederik Premti	Prof.Dr.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Aleksandër Çoho	Dr.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Besmir Kanushi	Msc	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Dolantina Hyka	Dr.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Erarda Vuka	Dr.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Grigorina Boçe	Msc	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Katerina Male (Zela)	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Marinela Shehaj	PHD	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Besjana Mema	Dr	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Jurgen Meçaj	Msc	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Lorena Saliqaj	PHD	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Matilda Luma	Drp.	PAE
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Mariela Meço	Bsc	PAE PNA
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Edgar Memishi	Dp	PAE PNA
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Artan Dhrami	Msc	PAK
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Neki Frasheri	Prof.Dr.	PAK
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Nikollaq Terezi	Dr.	PAK
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Veranda Syla	Msc	PAK
FI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit	Valdete Duraku	Msc	PAK
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Erdet Lalaj	Drp.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Florjan Bombaj	PHD	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Greta Angjeli	Prof.Dr.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Ornela Hogu	Msc	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Sulo Haderi	Prof.Dr.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Alma Hyra	Drp.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Vebina Resuli	PHD	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Fatos Ylli	Prof.Dr.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Brisela Mehmetllari	Msc	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Jusuf Qarkaxhia	Prof. Assoc.Dr.	PAE
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Bukurie Dumani	Prof.Dr.	PAK
FI	Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale	Majlinda Cenameri	Dr.	PAK

*Tabela 5. Personeli Fakulteti i Shkencave Mjekësore*

FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Besa Hyseni	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Valbona Doçi (Tahiraj)	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Ina Çami	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Brunilda Duriçi	Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Valentina Arapi	Prof. Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Ira Spahiu	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Shpëtim Qyra	Prof.Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Dea Guri	Msc.	PAE
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Leandro Xhama	Dr.	PAK
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Brikena Muja (Përlaku)	Drp.	PAK
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Mirela Lika	Prof.Dr.	PAK
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Feim Gashi	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Sistemeve Digjitale Mjekësore	Olsi Feimi	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Eranda Koçiko	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Gazmir Gjoni	Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Arian Boci	Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Olisian Sulaj	Msc.	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Arvi Goreja	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Marina Hida	Msc	PAE
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Adelajda Cerekja	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Teknologjive Mjekësore	Përparim Kabo	Prof.Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Svetlana Bitincka	Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Mihal Tase	Prof.Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Ariana Pojani	Msc.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Elton Serani	Drp.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Edlira Bode	Drp.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Besnik Jakaj	Dr.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Jozel Hilla	Drp.	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Valbona Distafa (Malaj)	MP	PAE
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Liljana Ramasaço	Dr.	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Raimonda Banaj (Lalaj)	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Valbona Salko	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Pavlo Djamandi	Dr.	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Flora Zyberaj	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Kimete Kadesha	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Eltona Malo	Msc	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Gentian Stroni	Prof.Assoc.Dr.	PAK
FSHM	Departamenti i Infermieristikës	Anila Cake	Msc.	PAK

- *Gjurmimi i studentëve*

Në përgjigje të nevojës për të gjurmuar studentët dhe në zbatim të strategjisë së UMSH për kujdesin ndaj studentit të diplomuar dhe përputhshmërinë e diplomës së tij me tregun e punës, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Studentit realizon vrojtimin vjetor në fillim të muajit mars<sup>2</sup>.

Vrojtimi mbështetet në një anketim me telefon që bëhet për të gjithë studentët e diplomuar, duke u drejtuar pyetjet si me poshtë:

- a) Nëse janë në marrëdhënie pune dhe kur e kanë filluar atë;
- b) Nëse punojnë në profesionin për të cilin studiuuan, apo janë jashtë specialitetit;
- c) Nëse kanë perceptimin që paga e tyre është e nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.

Të dhënat nga komunikimet e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës mbi punësimin e të diplomuarve përgjatë viteve të fundit akademike, sipas programeve të studimit bachelor tregojnë një nivel të kënaqshëm punësimi, në përputhje me diplomën. Njëkohësisht merret parasysh fakti që një pjesë e të diplomuarve vazhdojnë studimet në ciklin e dytë. Nëse marrim në konsideratë punësimin e studentëve që kanë vazhduar studimet në UMSH dhe të atyre të punësuar direkt pas ciklit të parë, shifrat e punësimit në vitet e mëparshme arrijnë mbi 80%.

Bazuar në Organigramën e UMSH-së si dhe në të gjitha aktet rregullatore të universitetit, ZKSK i ka dhënë departamenteve mbështetjen e saj në procesin e praktikave, për studentët në Bachelor dhe në Master. Kjo zyrë ka qenë përgjegjëse për implementimin e zhvillimit të praktikave dhe mbarëvajtjen e tyre, gjithnjë në mbështetjen të departamentit. Për një funksionim sa më të drejtë dhe transparent të tutoriatit, ZKSK ka dhënë kontributin e saj për organizimin dhe dokumentimin e këtij procesi. Bazuar në organigramën e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, ka përcaktuar një ditë dhe një orë të vecantë për pritjen e çdo studenti në nevojë për tutoriat dhe këshillim akademik. Me kontributin e anëtarëve të ZKSK, pasi është mundësuar ndjekja e

---


<sup>2</sup> Të dhënat e studentëve të diplomuar në vitin akademik 2024/2025, përpunohen dhe shpallen të plota në mars 2026.

praktikave, është realizuar edhe punësimi i një numri të konsiderueshëm studentësh në vendin ku ata i kanë realizuar praktikat. Grafikët e mëposhtëm tregojnë të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar në vitin akademik 2024/2025.


#### Punësimi i studentëve të diplomuar në programet Diplomë profesionale gjatë vitit akademik 2024/2025




#### Punësimi i studentëve të diplomuar në programet Bachelor gjatë vitit akademik 2024/2025



#### Punësimi i studentëve të diplomuar në programet Master profesional gjatë vitit akademik 2024/2025





### - *Këshilli studentor dhe përfaqësimi e tij në UMSH*

Studentët në UMSH janë të organizuar zyrtarisht në organin përfaqësues të Këshillit Studentor bazuar në nenet 54 dhe 55 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Statutit të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”, neni 81, pika c. Këshilli Studentor i UMSH është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Këshilli Studentor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është organi kolegjal më i lartë i përfaqësimit studentor brenda institucionit, përgjegjës për përfaqësimin e studentëve në jetën institucionale dhe përmirësimin e jetës studentore. Anëtarë të Këshillit Studentor, përfaqësojnë studentët në organet kolegiale të UMSH Senat Akademik, Komisioni i Përhershëm i Fakultetit, etj.

- Këshilli Studentor përbëhet nga anëtarët e zgjedhur të cilët konsiderohen përfaqësues me te drejtë vote, sipas numrit të përcaktuar sipas Nenit 12/3 të rregullores së zgjedhjeve.
- Këshilli Studentor përbëhet edhe nga anëtarë pa të drejtë vote, të miratuar nga vetë ai, të cilët angazhohen pranë Komisioneve të Këshillit Studentor.

Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve si dhe funksionon sipas një Rregulloreje të posaçme. Studentët përfaqësohen në mbledhjet e departamentit nga përfaqësuesi i tyre i cili sjell ne departament shqetësimet e tyre për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentët përfaqësohen edhe ne forumet e tjerë drejtues, sipas rregulloreve të

institucionit dhe forumeve përkatëse. Studentët janë të ftuar edhe në shumë aktivitete shkencore apo diskutime për probleme e zhvillime strategjike të institucionit.

Këshilli Studentor i UMSH shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit të Institucionit, duke filluar nga planet dhe programet e studimeve, duke vazhduar tek rregulloret për veprimtaritë mësimore, dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Studentët e UMSH përfaqësohen në Këshillin Studentor, organi që përfaqëson interesat dhe adreson çdo problematikë të hasur nga studentët gjatë jetës së tyre universitare në organet drejtuese të institucionit. Këshilli merret me organizimin e një sërë aktiviteteve të tilla si Konferenca Studentore, Kinemaja Politike, promovimi i aktiviteteve të ndryshme si dhurimi i gjakut, aktivitete për mbledhjen e fondeve për fëmijët në nevojë, organizimi i mbrëmjeve studentore dhe aktivitete të tjera rinore. Studentët janë të organizuar gjithashtu në “Klubet Studentore”.

Gjatë vitit akademik 2024/2025, Këshilli Studentor i UMSH ka vijuar aktivitetin e tij me objektivin për të forcuar përfaqësimin studentor dhe bashkëpunimin me strukturat e universitetit.

- Këshilli ka zhvilluar takime të hapura me studentët, duke mbledhur mendime dhe propozime për përmirësimin e shërbimeve universitare.
- Janë organizuar fushata sensibilizuese, videomesazhe dhe rubrika reflektuese, të shpërndara në kanalet zyrtare të UMSH dhe në kanalet Instagram dhe Facebook të vetë Këshillit studentor.
- Këshilli studentor ka qenë aktiv në ngjarje sociale dhe bamirësie, me veprimtari të zhvilluara brenda dhe jashtë universitetit, duke nxitur frymën e solidaritetit dhe bashkëpunimit mes studentëve. Të gjitha aktivitetet janë të pasqyruara në faqen e Instagramit dhe Facebookut të Këshillit studentor.

#### - ***Klubet studentore***

Klubet Studentore në Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, janë formuar nga studentët e programeve dhe cikleve të ndryshme të studimit në UMSH, bazuar në interesa dhe kërshëri studimi të përbashkëta, programeve të studimit ose qëllimeve të tjera të përbashkëta dhe të përafërta. Studentët i bashkohen klubeve për t'u përfshirë në aktivitete në fusha ku ata janë të pasionuar, për t'u shoqëruar me studentë dhe individë me të cilët ndajnë të njëjtin mendim dhe për të kontribuar

në krijimin e një ndjenje komuniteti dhe përkatësie brenda mjedisit akademik të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

Klubet Studentore mbulojnë një gamë të gjerë interesash dhe aktiviteteve, duke përfshirë klubet e debatit, klubet shkencore ose klubet gjuhësore, organizatat kulturore dhe artistike, klubet sportive, grupet e shërbimit në komunitet dhe më tej. Anëtarësimi në një klub studentor ofron një mundësi për rritje personale, zhvillim të aftësive dhe përfshirjen në netëorks me individë me të cilët ndajnë interesa të ngjashme. Klubet Studentore në UMSH zhvillojnë takime 2-3 herë në muaj në formë debatesh, tryeza të rumbullakëta, diskutime për tema të fushave si dhe të ftuar të fushave të ekspertizës që mbulohen nga departamenti.

Për të forcuar jetën studentore, ZKSK ka vijuar mbështetjen e klubeve studentore të ngritura në vitet e mëparshme, duke i shndërruar ato në hapësira aktive bashkëpunimi, diskutimi dhe zhvillimi profesional.

Klubet zhvillojnë takime dy herë në muaj, në formën e debateve, tryezave të rumbullakëta dhe prezantimeve tematike me pjesëmarrjen e pedagogëve mentorë dhe të ftuarve nga fusha të ndryshme profesionale. Për Klubet sportive, Futboll djem dhe Volejvull vajza takimet janë zhvilluar në terrene sportive. Zhvillimi stërvitor dhe garat me shkolla apo universitete të tjerë gjenden të dokumentuar edhe në faqen e Këshillit Studentor (Instagram dhe Facebook)

Klubet e UMSH për vitin akademik 2024/2025:

1. “Juristët e së ardhmes”
2. “Encryption Texts”
3. “Financieri i Nesër”
4. “Menaxherët e së ardhmes”
5. “Studime Ndërkombëtare dhe Shkenca Politike”
6. “Reflektimi i Edukimit Kolektiv”

7. “Trouble Shooters”
8. “Klubi i Debatit”
9. “Klubi i Futbollit”
10. “Klubi i Volejbollit”
11. “Klubi i Mjekësisë”

Studentët janë të lirë të marrin pjesë në çdo klub, sipas interesit të tyre.

Materialet, fotot dhe raportet e takimeve publikohen periodikisht në faqet zyrtare të universitetit, faqen zyrtare të Këshillit studentor në kanalet Instagram dhe Facebook si dhe ruhen në dosje pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Studentëve.

### ***c. KËRKIMI SHKENCOR***

Më poshtë është vlerësimi i aktivitetit shkencor të institucionit gjatë vitit akademik 2024/2025 dhe është ndërtuar si përmbledhje e raportimeve të aktiviteteve shkencore që Fakultetet kanë dorëzuar pranë Rektoratit. Objektivat kryesorë të kërkimit shkencor gjatë kësaj periudhe kanë harmonizuar plotësimin e synimeve afatshurtër me objektivat afatgjatë të institucionit. Të gjitha këto përpjekje janë realizuar në funksion të strategjisë së re të zhvillimit të institucionit.


## **I. DREJTIMET KRYESORE TË VLERËSIMIT TË AKTIVITETIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT.**

1. *Lidhja e aktivitetit kërkimor dhe shkencor me programet mësimore dhe procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.*

Siç theksohet edhe në strategjinë e re të institucionit: “aktiviteti shkencor duhet t’i paraprijë dhe të jetë në funksion në radhë të parë të mësimdhënies dhe mësimnxënies”. Në këtë aspekt të gjitha ndryshimet e bëra si në strukturën e institucionit ashtu dhe në përmbajtjen e produkteve universitare të tij kanë qenë fryt i studimeve të hollësishme të tregut universitar, tendencave të reja të tregut të punës, ndryshimit të profesioneve dhe aspektet e reja në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies që ofron teknologjia digjitale. Si pasojë institucioni ka zhvilluar më tej si strukturën mësimore të lëndëve brenda kërkesave ligjore, ashtu dhe infrastrukturën mësimore në digjitalizimin e programeve, mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kërkimi shkencor ka qenë pararoja e gjithë këtij procesi.

Elementi kryesor dhe direkt i lidhjes së punës shkencore me atë mësimore kanë qenë infomacionet shkencore. Stimulimi i informacioneve shkencore ka pasur rezultate positive si në përmirësimin dhe modernizimin e përmbajtjes së lëndëve ashtu dhe në rritjen profesionale të pedagogëve. Informacionet shkencore kanë qenë burimi i ndryshimeve me 20% të disa lëndëve në funksion të modernizimit të tyre, por njëkohësisht duke u bërë objekt diskutimesh në departamente ato kanë rritur horizontin konceptual të pedagogëve edhe jashtë fushave të tyre të kompetencës. Ky proces është shoqëruar pastaj si me ndryshime në lëndë të caktuara, por njëkohësisht dhe në rishikim të literaturës së caktuar për çdo lëndë. Të dy këto elementë kanë bërë të domosdoshme për të pasuruar edhe fondin e librave dhe literaturës elektronike të bibliotekës së institucionit. Më poshtë po japim disa të dhëna për informacionet shkencore të organizuara sipas fakulteteve.

Tabela 1. Informacione shkencore sipas fakulteteve




Informacionet shkencore kanë shërbyer si bazë thelbësore për përmirësimin e programeve të studimit përmes zbatimit të sistemit 20%, i cili është reflektuar qartë si në programet Bachelor, ashtu edhe në ato Master në Fakultetin e Shkencave Ekonomike. Ky mekanizëm ka mundësuar integrimin e përmbajtjeve të reja, përditësimin e literaturës dhe rritjen e koherencës midis objektivave mësimorë dhe nevojave bashkëkohore të tregut të punës. Njëkohësisht, përdorimi sistematik i burimeve shkencore ka krijuar hapësira për zhvillimin e diskutimeve më të thelluara teorike, duke nxitur mendimin kritik dhe analizën krahasuese të studentët. Këto diskutime kanë kontribuar drejtpërdrejt në modernizimin e leksioneve, veçanërisht në lidhje me temat emergjente si inteligjenca artificiale, transformimi digjital dhe ndikimi i teknologjive të reja në shkencat ekonomike. Në këtë mënyrë, procesi mësimor është bërë më dinamik, më aktual dhe më i orientuar drejt kërkimit shkencor.

## *2. Ndikimi i aktivitetit shkencor në rritjen profesionale të pedagogëve.*

Kapitali intelektual është pasuria më e madhe e këtij institucioni dhe rritja e tij është faktori kryesor i përmirësimit të vazhdueshëm të pozicionit të tij në treg. Kjo do të thotë që me politikën e tij të përthithjes së personelit akademik të ri akademik dhe me nxitjen dhe stimulimin e pedagogëve egzistues, UMSH ka arritur të ndryshojë ndjeshëm strukturën e trupit pedagogjik në funksion të gradave dhe titujve shkencorë. Ndryshimi i strukturës së pedagogëve në funksion të gradave dhe titujve më të lartë ka hapur mundësi të reja si për fushat e studimit ashtu dhe për cilësinë e punës shkencore. Më poshtë shohim ndryshimet në 3 vitet e fundit të këtij fenomeni.

Tabela 2. Zhvillimi i kapitalit njerëzor në tre vitet e fundit(2023-2025)



Për kategorinë e mesme, “Prof.Asoc.Dr.”, rritja është e dukshme dhe e qëndrueshme, duke treguar një zhvillim cilësor të stafit. Në mënyrë konkrete, nga 18 pedagogë që ishin në vitin akademik 2022-2023 në këtë kategoria arriti në 26 persona në vitin 2024-2025, duke regjistruar një rritje prej 8 pedagogësh ose afërsisht 44%. Një progresion i ngjashëm, edhe pse më i moderuar, vërehet edhe te kategoria më e lartë, “Prof. Dr.”, ku nga 18 persona në 2022-2023 kemi kaluar në 23 persona në 2024-2025, me një shtesë prej 5 profesorësh të rangut të plotë. Megjithatë, rritja numerikisht më e madhe ka ndodhur në bazën piramidale, te kategoria e “Dr.” dhe “PhD”, ku nga 56 akademikë në fillim të periudhës kemi arritur në 62 në fund të saj. Kjo dinamikë e përgjithshme tregon, nga njëra anë, një politikë të vazhdueshme rekrutimi me kriterë akademike, duke siguruar një fluks të ri intelektual si baza e rritjes së ardhshme. Nga ana tjetër, ajo pasqyron qartë një stimulim të suksesshëm të brendshëm të stafit akademik ekzistues për të avancuar shkencërisht dhe për të kaluar në kategoritë më të larta, duke forcuar kështu kapitalin njerëror të institucionit në mënyrë të qëndrueshme dhe cilësore.

Në përmbljedhje, grafikoni tregon qartë se universiteti ka përjetuar një zgjerim të konsiderueshëm dhe cilësor të stafit akademik në të gjitha nivelet, me një përqendrim të veçantë në fortësimin intelektual. Kjo tregon një strategji të suksesshme për rritjen e kapitalit njerëror, duke investuar në zhvillimin e karrierës së akademikëve ekzistues dhe në tërheqjen e talenteve të reja. Një kapital njerëror i pasur dhe i kualifikuar si ky është themeli për një prestigj më të lartë akademik, aftësi

më të mëdha kërkimore, oferta më të larta dhe cilësore programesh studimi, dhe në fund të fundit, një ndikim më të madh shoqëror dhe ekonomik. Rritja në numër, veçanërisht te profesorët e rangut të lartë, nuk është thjesht një numër; ajo pasqyron një thellim të ekspertizës, një zgjerim të fushave të kërkimit dhe një përforsim të kapaciteteve mësimore të universitetit, duke e bërë atë një institucion më konkurrues dhe tërheqës në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

### *3. Studimet doktorale dhe roli i tyre në aktivitetin kërkimor dhe shkencor të institucionit.*

Hapja dhe konsolidimi i studimeve doktorale ka përfaqësuar një pikë kthese për zhvillimin akademik dhe kërkimor të universitetit, duke riorganizuar të gjithë arkitekturën e cikleve të studimit dhe duke rritur ndjeshëm vlerën e kapitalit njerëzor institucional. Ndërtimi i një projekti të integruar kërkimor, me disa akse kryesore studimi dhe me rreth 50 doktorantë aktivë në tri thirrje e para, ka krijuar një ekosistem të ri ku kërkimi shkencor nuk trajtohet më si aktivitet periferik, por si boshti qendror i zhvillimit universitar.

Hapja e studimeve doktorale ka riorganizuar gjithë sistemin e punës shkencore duke ndërtuar një projekt të madh studimi me fusha të ndërlidhura në Fakultetet e Shkencave Ekonomike dhe Informatike. Arritjet me të dukshme në këtë drejtim janë:

#### **3.1.Në fushën : Financë dhe Qeverisje Korporatash**

Në fushën e Financës dhe Qeverisjes Korporatash, proceset e avancuara të rivlerësimit të literaturës, diskutimet periodike në departament dhe përgatitja për juritë kanë rigjallëruar debatin shkencor, duke e orientuar atë drejt problematikave reale të ekonomisë shqiptare. Ky proces ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në rritjen profesionale të stafit akademik, veçanërisht të pedagogëve me Master Shkencor, të cilët kanë zgjeruar fushat e tyre të interesit dhe angazhimit kërkimor.

Në këtë kas studimi kemi 4 doktorantë që kanë kaluar me sukses proceset e studimeve doktorale disa edhe te vitit te dyte dhe disa te tjere te vitit te trete. Ata kanë përmbyllur fazën e rivlerësimit të literatures dhe kanë realizuar dy diskutime në department, ndersa dy prej tyre kane kaluar dhe fazen e departaemntit duke u pergatitur per juri. Nëpërmjet këtij procesi kanë zhvilluar ndjeshem debatin shkencor në department dhe kane rritur shkallen e diskutimit per probleme praktike te ekonomise shqiptare. Zhvillimi dhe mbrojtja e detyrimeve të vitit të parëte dyte dhe te trete të

doktoraturës ka krijuar mundësinë edhe për zgjerimin e fushave të interesit nga anëtarët e departamentit ne pergjithesi por vecanarisht atyre me Master Shkencor per rritjen e metejsshme profesionale.

### 3.2.Në fushën: Politikat e Tregjeve dhe Institucioneve Ekonomike dhe Financiare

Në drejtimin e Politikave të Tregjeve dhe Institucioneve Ekonomike dhe Financiare, përfshirja e profesionistëve nga sistemi bankar dhe financiar ka ndërtuar ura të qëndrueshme midis teorisë akademike dhe praktikës institucionale. Kjo ka përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe ka orientuar temat e doktoraturave drejt nevojave konkrete të tregut të punës.

Në këtë fushë kemi 6 doktorantë që vijnë jo vetëm nga sistemi universitar por dhe nga institucione bankare dhe financiare. Edhe këta studentë kanë kaluar me sukses fazat perkatese të studimeve doktorale. Të gjithë kanë realizuar objektivat për temat përkatëse dhe janë në fazën e perparuar te realizimit të doktoraturës. Këta studentë kanë sjellë në departamentin përkatës shumë elementë pozitiv të zgjidhjes së problemeve praktike dhe kanë ndihmuar në lidhjet e elementeve studimore me nevojat e tregut te punës duke ofruar eksperiencia të praktikës mësimore nga institucionet që punojnë.

### 3.3.Në fushën e Menaxhimit, Politikave ekonomike te zhvillimit dhe Marketingut

Ndërkohë, fusha e Menaxhimit, Politikave të Zhvillimit dhe Marketingut ka prodhuar një ndikim të gjerë praktik, duke përfshirë drejtime si marketingu digjital, menaxhimi mjekësor, barazia sociale, turizmi dhe internacionalizimi i arsimit të lartë. Këto kërkime kanë kontribuar jo vetëm në lidhjen me biznesin, por edhe në procesin e ndërkombëtarizimit të institucionit.Në këtë fushe kemi 21 doktorantë që kanë realizuar plotesisht detyrimes e procesit. Vend të rëndësishëm në këtë drejtim doktoral zënë fushat e marketingut sidomos ato të marketingut digjital, por dhe fushat e manaxhimit mjeksor dhe të drejtimit të politikave ekonomike te zhvillimit barazise sociale, turizmit, etj. Të gjitha fushat e kërkimit të këtij drejtimi janë praktike dhe të zbatueshme. Studentet doktoral të ketyre fushave kanë dhënë kontributet e tyre sidomos në ndërtimin e aspekteve praktike për lidhjen me biznesin dhe tregun e punës. Po në këtë fushë kemi edhe një temë për manaxhimit dhe internacionalizimin e arsimit universitar. Ky drejtim ka sjellë përfitime konkrete edhe për ndërkombëtarizimin e institucionit tonë.

#### *3.4.Në fushën: Aplikimet e Teknologjisë së Informacionit dhe të Informatikës në Ekonomi*

Së fundi, aplikimet e Teknologjisë së Informacionit në Ekonomi kanë krijuar profile të reja ekspertize në fusha si Cloud Computing, Data Warehouse dhe IT Project Management, duke forcuar lidhjet me sektorin privat dhe duke përgatitur kapital njerëzor me kompetenca të avancuara teknike.

Në këtë fushë kemi 19 doktorantë që kanë kaluar me sukses fazat e perkatese të studimeve doktorale sipas viteve. Studimet doktorale në Aplikimet e Teknologjisë së Informacionit dhe të Informatikës në Ekonomi, mundësojnë doktorantët, që nga njëra anë të sigurojnë një edukim të thelluar teknik në Sistemet e Informacionit, por edhe të zhvillojnë aftësi të nje lidhjeje të ngushtë me tregun dhe bizneset. Gjithashtu, profilet e këtyre doktoranteve do i mundësojnë edhe studentëve të këtij fakulteti të fitojnë ekspertizë të thelluar në drejtime si: IT project Management, Ndertimi i ERP-ve apo CMR-ve te dedikuara, etj. Ata janë të lidhur me proceset mësimore por dhe me firmat private në tregun shqiptar.

Në tërësi, studimet doktorale janë shndërruar në motorin kryesor të modernizimit institucional, duke rritur cilësinë e botimeve, pjesëmarrjen në projekte të financuara dhe rolin aktiv të pedagogëve në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Duhet theksuar se studimet doktorale kanë ndryshuar jo vetem drejtimet e punës kërkimore dhe shkencore, por ju kanë dhënë mundësi të gjithë trupit pedagogjik të lidhet më shumë me tregun, të ketë rol më aktiv në aplikimet në projekte të financuara nga Shteti Shqiptar apo Organizma Ndërkombëtare dhe të rrisë sasinë dhe cilësinë e botimeve. Ato janë bërë motori kryesor i nxitjes së vazhdueshme të pedagogëve në këtë drejtim.

#### *4. Trasferimi dhe përhapja e punës shkencore brenda dhe jashtë institucionit.*

Këtë vit institucioni ka bërë një punë të lavdërueshme për përhapjen e transferimin e punës shkencore si brenda ashtu edhe jashtë tij. Premisë për këtë janë bërë revista Euromediterranian dhe dy revista e tjera që janë në vitin e 4 të veprimtarisë së tyre EkoInfoSistem dhe Politea.

NR.19

EURO  
MEDITERRANEAN



THE CHALLENGE OF DIGITAL  
TRANSFORMATION

POLITEIA

Revistë shkencore  
për studime juridike, sociale dhe politike



UMSHPRESS  
Qershor 2023

**EKOINFO-SISTEM**

KËRKIME NË SHKENCAT EKONOMIKE DHE INFORMATIKE



UMSHPRESS



Revistat si pjesë e shtëpisë botuese UMSH Press kerkojnë të botojnë studime, kërkime, vëzhgime dhe analiza në fushën e ekonomisë, filozofisë, shkencave sociale dhe informatikës. Ato synojnë dhe kanë arritur të nxisin debatin shkencor në këto disiplina, jo vetëm për tregun universitar shqiptar, por edhe për subjektet e biznesit të ekonomisë së vendit. Me punimet e tyre këto revista kërkojnë të realizojnë një mbeshtetje qoftë dhe modeste për gjithë të interesuarit në rritjen e konkurrencialitetit të subjekteve ekonomike, zhvillimit të nivelit të tyre të digjitalizimit, nxitjen e forcës eksportuese dhe çdo element manaxherial që ndikon në rritjen e rendimentit të punës. Ato kanë elementë interesantë në diskutime, informacione dhe analiza në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare në aspekte të fenomeneve dhe reformave në drejtësi dhe në fusha të tjera me interes në tregun shqiptar.

Bordi editorial dhe gjithë elementët e strukturës organizative të këtyre revistave janë të përkushtuar që të rrisin mundësinë e botimeve si me problematika teorike ashtu dhe me rekomandime praktike, në mënyrë që në fushat përkatëse mundësia e botimit të jetë shumë e lartë. Kjo politikë realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë të bordeve editoriale me autorët e artikujve që nga faza e paraqitjes së tyre deri sa ato marrin formën përfundimtare për botim. Njëkohësisht i gjithë procesi i rishikimit, sygjërimit, rikonceptimit problemor të përmbajtjes, pasqyrimit të vërejtjeve të çdo

artikulli është tërësisht i fshehtë, duke garatuar objektivitetin e vlerësimit, barazmundësinë e botimit dhe mbi të gjitha cilësinë e punimit.

Këto revista synojnë t'u shërbejnë interesave të studiuesve parësorë, pedagogëve dhe studentëve të universiteteve të vendit dhe publikut të gjerë. Të gjithë autorët që botojnë në këto revista do të përfitojnë një ripozicionim të tyre në tregun e botimeve, ndërtimin e marrëdhënieve më aktive me studentët dhe pedagogët dhe mbi të gjitha më shumë prezencë në problematikat teorike dhe praktike të tregut shqiptar.

Pjesë e rëndësishme e përhapjes së punës shkencore janë dhe botimet e monografive me logon e UMSH-së dhe mbi të gjitha botimet shkencore me profesorë të universiteteve të huaja me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi. I kombinuar me koferencat shkencore procesi i botimeve është një mjet i rëndësishëm për përhapjen dhe transferimin e punës shkencore.

Pedagoget e UMSH përveç botimeve në revistat e intitucionit kanë bërë dhe botime në revista nderkombetare të klasifikuara sipas rëndësise së tyre. Një pamje të përgjithshme të botimeve të artikujve shkencore mund ta shikojmë edhe në tabelën që vijon:

Tabela 3. Artikuj shkencore sipas klasifikimit të revistave dhe sipas fakulteteve

Lloji i artikullit/ fakulteti	FDSHH	FI	FSHE	FSHM	Totali
Artikull me scopus ose ekuivalent me të	6	7	6	0	19
Artikull me faktor impakti dhe bord ndërkombëtar	8	9	11	2	30
Artikuj të tipit B sipas udhëzimit të MAS	12	8	9	1	30
Artikuj të tipit C sipas udhëzimit të MAS	7	8	13	0	28

Një element i rëndësishëm i përhapjes së punës shkencore ka qenë dhe pjesëmarrja e antareve të institucionit në koferenca shkencore kombetare dhe nderkombetare. Të dhënat për këtë proces i gjejmë tabelën që vijon.

Tabela 4. Pjesëmarrje në koferenca shkencore sipas fakulteteve

Fakultetet	Nr i pjesëmarrësve në koferenca

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane	53
Fakulteti i Shkencave Ekonomike	42
Fakulteti i Informatikës	38
Fakulteti i Shkencave Mjekësore	5

Të dhënat mbi botimet me logon e universitetit, konkretisht 5 tekste mësimore dhe 9 monografi të shpërndara ndërmjet FDSHH, FI, FSHE dhe FSHM, dëshmojnë për një rol gjithnjë e më të strukturuar të institucionit në ndërtimin e literaturës shtesë dhe ndihmëse për procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Këto tekste dhe monografi, të cilat mbulojnë fusha të ndryshme nga shkencat ekonomike dhe informatika deri te shkencat humane dhe menaxheriale, përfaqësojnë një pasurim real të bazës bibliografike të universitetit dhe reduktojnë varësinë nga literatura e huaj, shpesh e papërshtatur me realitetin shqiptar.

Tabela 5. Botime tekste dhe monografi per vitin 2024-2025 me logon e UMSH

Lloji i botimit	FDSHH	FI	FSHE	FSHM	Totali
Tekste mesimore	3	0	1	1	5
Monografi	2	3	3	1	9

Përfshirja e tyre si literaturë referuese në programet Bachelor, Master dhe Doktoraturë rrit cilësinë e formimit akademik, duke i ofruar studentëve materiale të hartuara nga pedagogë të përfshirë drejtpërdrejt në kërkimin shkencor dhe në problematikat konkrete të vendit. Në të njëjtën kohë, ky volum monografish ndikon drejtpërdrejt në ripozicionimin e universitetit në tregun universitar, pasi e shfaq atë jo vetëm si institucion mësimdhënës, por si prodhues aktiv të dijes shkencore dhe si aktor me identitet akademik të dallueshëm. Botimet me logon institucionale përbëjnë një element të rëndësishëm të markës akademike të universitetit, duke rritur besueshmërinë e tij ndaj studentëve, partnerëve dhe institucioneve financuese.

Së fundi, këto monografi luajnë një rol të pazëvendësueshëm në përhapjen e kërkimit shkencor në Shqipëri, sepse krijojnë një platformë të qëndrueshme për publikimin në gjuhën shqipe të

rezultateve kërkimore, nxisin debatin akademik kombëtar dhe kontribuojnë në ndërtimin e një tradite vendase të shkrimit shkencor, e cila është themel për zhvillimin afatgjatë të arsimit të lartë dhe inovacionit.

## **II. RITJJA E INFRASTRUKTURES MESIMORE DHE SHKENCORE.**

Zhvillimi i bazës materiale për punën shkencore përbën një nga shtyllat kryesore të strategjisë së universitetit për rritjen e cilësisë akademike dhe fuqizimin e kërkimit shkencor, dhe në këtë drejtim gjatë periudhës së fundit janë realizuar investime të konsiderueshme me ndikim të drejtpërdrejtë në procesin mësimor dhe kërkimor.

Një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore ka qenë ndërtimi i bibliotekës së re për Fakultetin e Mjekësisë, e konceptuar si një hapësirë moderne studimi dhe kërkimi, me kapacitet depozitimi deri në 20.000 tituj. Kjo bibliotekë jo vetëm që plotëson nevojat bazë të studentëve dhe stafit akademik për literaturë të specializuar, por krijon edhe kushte për zhvillimin e punës kërkimore në përputhje me standardet bashkëkohore, duke e pozicionuar fakultetin si një qendër reference për studimet mjekësore në nivel kombëtar.

Paralelisht, janë siguruar dy platforma të reja digjitale për akses në libra dhe revista shkencore ndërkombëtare, të cilat u kanë dhënë pedagogëve, doktorantëve dhe studentëve mundësinë të lidhen drejtpërdrejt me literaturën më të fundit, të rrisin cilësinë e punimeve akademike dhe të përmirësojnë dukshëm procesin e citimit dhe referencimit shkencor. Këto platforma përbëjnë një instrument të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe për rritjen e konkurrueshmërisë së universitetit në tregun e arsimit të lartë. Me konkretisht:

Platforma eBooks Nursing përfaqëson një burim strategjik për Fakultetin e Shkencave Mjekësore, duke ofruar akses të strukturuar në literaturë bashkëkohore në fushën e infermierisë, shëndetit publik dhe disiplinave të afërta klinike. Ky koleksion digjital siguron qasje në libra të përditësuar shkencërisht, të cilët përmbajnë protokolle trajtimi, studime rastesh, udhëzime praktike dhe zhvillime të fundit në fushën e kujdesit shëndetësor. Rëndësia e kësaj platforme qëndron në faktin se literatura mjekësore është një nga fushat më dinamike dhe me ritmin më të shpejtë të

ndryshimeve, çka e bën të domosdoshëm përditësimin e vazhdueshëm të burimeve mësimore. Përmes eBooks Nursing, studentët dhe pedagogët fitojnë mundësi të lidhen drejtpërdrejt me standardet ndërkombëtare të praktikës infermiere, duke rritur cilësinë e formimit profesional dhe të kërkimit shkencor. Platforma kontribuon gjithashtu në zhvillimin e aftësive për kërkim bibliografik, analizë kritike të literaturës dhe ndërtimin e punimeve akademike mbi baza të forta shkencore.

Në mënyrë komplementare, platforma eBooks – IT & Economics shërben si një bosht i rëndësishëm për Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Fakultetin e Shkencave Ekonomike. Kjo platformë ofron një gamë të gjerë librash elektronikë në fusha si sistemet e informacionit, menaxhimi i projekteve IT, analiza e të dhënave, ekonomia, financa, marketingu, menaxhimi dhe politika publike. Për studentët e këtyre drejtimeve, qasja në literaturë të përditësuar ndërkombëtarisht është thelbësore për të kuptuar trendet globale, modelet e reja të biznesit dhe zhvillimet teknologjike që ndikojnë drejtpërdrejt në tregun e punës. Platforma krijon kushtet që procesi mësimor të mos mbështetet vetëm në tekste tradicionale, por të pasurohet me burime bashkëkohore, të cilat ndihmojnë në integrimin e teorisë me praktikën.

Të dyja këto platforma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit të bibliotekës universitare dhe ndërkombëtarizimit të procesit akademik. Ato reduktojnë ndjeshëm barrierat fizike dhe financiare për akses në literaturë cilësore, duke u dhënë mundësi studentëve dhe stafit akademik të punojnë në mënyrë fleksibile, nga çdo mjedis dhe në çdo kohë. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm për doktorantët dhe pedagogët e përfshirë në projekte kërkimore, të cilët kanë nevojë për burime të shumta dhe të specializuara për të ndërtuar korniza teorike solide dhe për të ndjekur zhvillimet më të fundit në fushat e tyre.

Në një këndvështrim institucional, investimi në këto dy platforma rrit ndjeshëm kapacitetet kërkimore të universitetit dhe kontribuon në ripozicionimin e tij si një institucion që prodhon dije dhe jo vetëm e transmeton atë. Qasja në eBooks Nursing dhe eBooks – IT & Economics krijon një bazë të qëndrueshme për rritjen e cilësisë së punimeve shkencore, për shtimin e botimeve akademike dhe për forcimin e rolit të universitetit në komunitetin shkencor kombëtar. Në këtë mënyrë, këto platforma nuk janë thjesht mjete teknike, por elementë kyç të strategjisë për zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor dhe për konsolidimin e identitetit akademik të institucionit.

Ndërkohë, prej disa vitesh janë në funksion edhe disa platforma të tjera digjitale në bibliotekat e UMSH-së. Një listë e plotë e tyre paraqitet në vijim:

1. Edward Elgar Publishing

<https://www.elgaronline.com/browse?access=user&level=parent>

2. The Company of Biologists

<https://www.biologists.com/biology-open/> Biology Open (BIO) reviste që publikon kerkime rigorozë me cilësi të lartë të shkencës biologjike dhe biomjekësore

Opsioni I lehtë I transferimit të Biology Open në revistat e mëposhteme:

<https://journals.biologists.com/dev/> Development of Journal

<https://journals.biologists.com/jcs/> Journal of Cell Science

<https://journals.biologists.com/jeb/> Journal of Experimental Biology

<https://journals.biologists.com/dmm/> Disease Model & Mechanisms

<https://journals.biologists.com/bio/> Open Biology

3. ERS (European Respiratory Society) Publications

<https://publications.ersnet.org/content/breathe> Breath Journal

<https://publications.ersnet.org/content/erjor> ERJ Open Research, Chronic cough

<https://publications.ersnet.org/content/erj> European Respiratory Journal

<https://publications.ersnet.org/content/errev> European Respiratory Review

<https://publications.ersnet.org/podcasts> Podcast. (ERP)

4. UNPAYWALL – artikuj shkencorë me qasje të hapur, (Cobiss.al)

Baza e të dhënave Unpaywall përmban më shumë se 31 milion artikuj shkencorë me qasje të hapur në tekst të plotë. Përmbajtjet në qasjen e hapur merren nga bazat e të dhënave të mbi

50.000 botuesve dhe repositorëve.

5. <https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/unpaywall>

Në të njëjtën kohë, mjediset mësimore janë pajisur me tabela elektronike dhe kompjuterë të gjeneratës së fundit, duke modernizuar ndjeshëm procesin e mësimdhënies dhe duke mundësuar aplikimin e metodave interaktive, përdorimin e softuerëve të avancuar dhe integrimin e teknologjisë digjitale në çdo cikël studimi.

Një tjetër investim strategjik me vlerë të lartë është ndërtimi i laboratorit të robotikës për Fakultetin e Shkencave Informatike, i cili ka krijuar kushte për zhvillimin e projekteve kërkimore aplikative, bashkëpunimin me sektorin privat dhe përgatitjen e studentëve me aftësi praktike të kërkuara nga tregu. Në tërësi, këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve kërkimore të institucionit, në përmirësimin e cilësisë së formimit akademik dhe në forcimin e rolit të universitetit si qendër prodhimi dijeshe dhe inovacioni.

Në përfundim, duhet theksuar se investimet në infrastrukturën materiale nuk përbëjnë thjesht një përmirësim teknik të mjediseve universitare, por krijojnë një bazë të qëndrueshme për transformimin cilësor të veprimtarisë kërkimore. Kur kjo infrastrukturë moderne kombinohet me kapitalin njerëzor të kualifikuar, pedagogë me formim shkencor, doktorantë aktivë dhe studentë të motivuar krijohen premiset reale për rritjen e standardeve akademike dhe për prodhimin e kërkimit me ndikim. Bibliotekat funksionale, platformat digjitale, laboratorët dhe pajisjet bashkëkohore e bëjnë më të lehtë qasjen në literaturë, eksperimentimin dhe zhvillimin e projekteve ndërdisiplinore, ndërsa burimet njerëzore i shndërrojnë këto asete në dije konkrete dhe rezultate të matshme. Ky sinergji midis infrastrukturës materiale dhe asaj njerëzore përbën themelin e një universiteti modern, konkurrues dhe të orientuar drejt inovacionit dhe zhvillimit afatgjatë.

Vetëm gjatë vitit akademik 2024/2025, investimet në infrastrukturën shkencore janë rritur me rreth 25% krahasuar me të gjitha vitet paraardhëse, duke shënuar nivelin më të lartë të financimit në këtë drejtim. Këto investime nuk janë fokusuar ekskluzivisht në Fakultetin e Mjekësisë, i cili ka përfituar nga ndërtimi i një godine të re të pajisur me të gjithë elementët e nevojshëm për mësimdhënie dhe kërkim, por janë shtrirë edhe në fakultetet e tjera, me theks të veçantë në Fakultetin e Shkencave Informatike, ku janë përmirësuar ndjeshëm kushtet infrastrukturore dhe

laboratorike.

### **III. ORGANIZIMI I EVENTEVE SHKENCORE DHE FINANCIMI I PEDAGOGEVE PER KERKIMIN SHKENCOR.**

Gjatë viteve akademike 2024/2025, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka shënuar një rritje të dukshme të angazhimit në aktivitetet shkencore dhe akademike, duke konsoliduar rolin e tij si një frymëzues i dialogut shkencor dhe i bashkëpunimit ndërdisiplinor. Kjo periudhë u karakterizua nga organizimi i disa konferencave të rëndësishme, të cilat ofruan platforma të vendosura mirë për prezantimin e rezultateve kërkimore, shkëmbimin e ideve dhe diskutimin e sfidave bashkëkohore.

Një nga aktivitetet kryesore ishte Konferenca e organizuar më 13 qershor 2025 në Tiranë me titull: “Kufijtë e të Drejtave të Njeriut: Dialogu midis Detyrimeve dhe Lirisë” Ajo u përqendrua në rolin dhe përgjegjësinë e qytetarëve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Qëllimi i konferencës është të shqyrtojë se si aspekte të ndryshme të jetës shoqërore dhe ligjore ndikojnë në marrëdhëniet midis individëve, shtetit, subjekteve ekonomike dhe organeve të zbatimit të ligjit dhe drejtësisë në kontekstin e zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konferenca e III-të Shkencore Studentore me temë “Inteligjenca artificiale dhe shoqëria”, zhvilluar më 15 maj 2025 ishte një aktivitet tjetër i rëndësishëm. Kjo konferencë u organizua në bashkëpunim ndërfaqultetesh dhe përfshiu zëra të ndryshëm nga Shkencat Humane, Drejtësia, Ekonomia, Informatika dhe Mjekësia. Ajo shërbeu si një mjet për të nxitur diskutime teorike dhe praktike, duke krijuar një platformë ku studentët dhe pedagogët ndanë kërkimet e tyre, identifikuan çështje emergjente dhe kontribuan në debatin akademik kombëtar. Materialet dhe kontributet më të spikatura u përzgjedhën dhe u botuan në revistën shkencore “Politeia”, duke fuqizuar kështu qarkullimin e dijes brenda komunitetit shkencor dhe rritur prezencën e tyre në literaturën akademike.

Një aktivitet tjetër ishte ai i organizuar nga departamenti i Shkencave Humane të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” me organizimin e Forumit Ndërkombëtar “Shkencat Psikologjike Sot”, i cili u mbajt më 2 maj 2025, në ambientet e universitetit. Ky forum përfaqëson një nismë

akademike me objektivin për të krijuar një platformë të qëndrueshme shkëmbimi ndërdisiplinor, ku studentët e ciklit Master Shkencor, së bashku me studiues të fushës, të prezantojnë punimet dhe projektet e tyre kërkimore me qasje empirike, teorike dhe analitike. Qëllimi kryesor i forumit është të nxisë zhvillimin e mendimit kritik dhe praktikave kërkimore bashkëkohore në fushën e psikologjisë dhe shkencave humane. Forumi synon të ofrojë një qasje të re ndaj psikologjisë si shkencë reflektuese dhe transformuese, ku rezultatet shkencore nuk qëndrojnë vetëm në funksion të akademisë, por gjejnë zbatim në politikat sociale, edukim dhe ndërhyrje komunitare.

Angazhimi i UMSH-së në disa konferenca nderkombetare si bashkepunor (Bullgari, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Kosove dhe Maqedonia e Veriut) tregon një përkushtim të qartë për të fuqizuar kërkimin shkencor, për të krijuar bashkëpunime akademike dhe për të rritur prezencën e universitetit brenda komunitetit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto aktivitete nxisin zhvillimin profesional të stafit akademik dhe të studentëve, duke i pajisur ata me eksperiencë të vlefshme dhe duke kontribuar drejt një ekologjie më dinamike dhe të integruar kërkimore.

Gjatë këtij viti shkollor kemi pasur dhe shumë aktivitete të rëndësishme shkencore duke filluar nga tavolinat e rumbullakta deri tek leksionet e hapura të mbajtura nga autoritete shkencore ndërkombëtare si:

- Û Prezantimi i botimi special të nr. 20 të revistës shkencore “EUROMEDITERANEAN” Studimet Doktorale. Ky botim, i parë në llojin e vet, i përkushtohet vetëm studimeve shkencore të studentëve të ciklit të tretë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.
- Û Në kuadër të Programit Erasmus dhe në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Ekonomike, u zhvillua leksioni i hapur në të cilin referoi Profesor Hacı Mevlut Karatas, i cili ka specializimin në ekonomiks dhe ekonometri. Ai ofroi një ekspertizë që përputhet me programin e zhvillimit të aftësive për studimet doktorale, të studentëve të Shkollës së Doktoraturës në “UMSH”.
- Û Zhvillohet në UMSH takimi i partnerëve të projektit LAIA Project LAIA (Laboratories of Artificial Intelligence in Albania and Kosovo) i financuar nga Bashkimi Europian. Të pranishëm në këtë takim, ishin përfaqësuesit nga Greqia, Danimarka dhe Kosova. Ky moment tregon fuqinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rëndësinë e ndarjes së njohurive përtej kufijve duke avancuar inteligjencën artificiale në fushën e arsimit dhe duke fuqizuar



studentët tanë për të krijuar zgjidhje që do të ndihmojnë në ndërtimin e një të ardhme më të ndritshme.

Gjatë këtij viti, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka zhvilluar aktivitete të shumta për të rritur internacionalizimin e veprimtarisë së tij akademike dhe shkencore në skenën ndërkombëtare.

#### **d. BASHKËPUNIMI**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i kushton një vëmendje të madhe zgjerimit të dimensionit të tij ndërkombëtar duke zbatuar vazhdimisht strategjinë e ndërkombëtarizimit. Mendojmë se ky proces ndihmon në rritjen e vizibilitetit të UMSH-së në mjediset universitare e më gjerë, duke u përfshirë në një numër të madh bashkëpunimesh dhe partneritetesh të ngushta me universitete të huaja dhe institute kërkimore ndërkombëtare.

Gjatë vitit të fundit akademik 2024/2025, shumë nga synimet e paracaktuara të procesit të ndërkombëtarizimit janë arritur. Gjatë këtij viti janë zgjeruar akoma më shumë bashkëpunimet me Institucionet e Arsimit të Lartë (Universitete publike dhe private) në Bashkimin Europian në kuadrin e programit Erasmus+. Aktualisht numërohen rreth 40 universitete të huaja të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me UMSH mbrenda këtij viti mësimor me qëllimin kryesor shkëmbimin e eksperiencës akademike ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Bazuar në këto marrëveshje Erasmus+ 30 pedagogë të brendshëm të UMSH kanë shkëmbyer eksperiencën e tyre akademike për afate të ndryshme në universitetet e huaja partnere. Ndërkohë rreth 40 pedagogë nga Universitete të huaja partnere kanë shkëmbyer eksperiencën e tyre akademike pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Nga ana tjetër, dhjetra studentë të programeve të ndryshme në UMSH kanë ndjekur studimet e tyre për një semestër akademik në një nga universitetet partnere në BE dhe anasjelltas.

UMSH në bashkëpunim me universitetet e tjera në BE kanë aplikuar në projekte të ndryshme me qëllim kryesor rritjen e kapaciteteve (Capacity Building) ku një pjesë e tyre janë shpallur fitues dhe pritet të vihen në zbatim në vitet në vazhdim, ndërsa një pjesë tjetër pritet akoma për një përgjigje nga institucionet përgjegjëse.

Kontributet e personelit akademik të UMSH-së në referencë të ekspertizës së individuale janë evidentuar edhe nëpërmjet komunikimit me publikun nëpërmjet pjesëmarrjes në debatet televizive apo në përgatitjet dhe diskutimet e dokumentave të politikave për proceset integruar duke bërë të prekshëm efektin social të tyre.

#### *- Bashkëpunime ndërinstytucionale*

Zhvillimi i procesit akademik universitar është i lidhur në mënyrë të veçantë me zgjerimin dhe konkretizimin e marrëveshjeve dhe memorandumëve të bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar me institucione arsimore apo kërkimore shkencore prestigjioze.

Marrëdhëniet institucionale që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka vendosur me universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, bëjnë pjesë në historikun e ngjarjeve shkencore të Institucionit tonë, dëshmojnë për një traditë të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunimi të gjithanshëm. Në perspektivën e bashkëpunimit të institucionit janë Universitete perëndimore, institucione dhe struktura të shërbimit publik dhe sektori privat.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është në marrëdhënie dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione arsimore vendase dhe të huaja, si dhe me kompani të ndryshme biznesi, me të cilat bashkëpunon në formë projektesh, konferencash dhe aktiviteteve të përbashkëta me qëllim zhvillimin e mëtëjshëm akademik dhe kërkimit shkencor. Në perspektivën e bashkëpunimit të institucionit janë kryesisht universitete perëndimore, institucione dhe struktura të shërbimit publik dhe sektorit privat.

Bashkëpunimi nëpërmjet Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me institucionet e tjera ka qenë i mundur si në nivel lokal, kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Për bashkëpunimin në nivel lokal mund të përmendim Memorandumin e Bashkëpunimit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me Bashkinë e Tiranës, Durrësit, Fierit, Elbasanit, Memorandumin me Kuvendin e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me kompaninë Pragmatics Analytics, AMD shpk (Applications Management Development), Shoqatën Kombëtare të Matematikës, Abcons Consulting Albania, Infosoft Group sh.p.k.

Përsa i përket bashkëpunimit kombëtar janë realizuar dhe jetësuar Marrëveshje Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, me Universitetin Bujqësor të Tiranës, Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin F.S. Noli, Memorandum, me Institutin e Studimeve Albanologjike, Memorandum Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe është një ndër aspektet kryesore të punës të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Për këtë lloj bashkëpunimi mund të përmendim “Memorandumin e Mirëkuptimit” të nënshkruar ndërmjet Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me Universitetin e Bolognes, Universitetin Aydin Istanbul, University of National and World Economy, Sofia/Bulgaria, Law and Internet foundation/Bulgaria, me Qendrën kërkimore CEMAS Sapienza, me Universitetin Aldo Moro, Bari, Marrëveshje Bashkëpunimi me Polytechnic Institute of Bragança, Portugali, Universitetin e Qipros; Universitetin e Strugës; Kolegjin Universitar “Biznesi” në Prishtinë etj. Një vëmendje të madhe j’u kushtua edhe lidhjes së MoU me disa institucione spitalore në Gjermani në kuadër të hapjes së Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Gjatë vitit akademik 2024/2025 janë nënshkruar disa marrëveshje të reja strategjike ku UMSH është angazhuar për realizimin e programeve të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit përmes:

- a. realizimit të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në unifikimin dhe njohjen e të kurrikulës apo lëndë të veçanta për programet e studimit që ofron;
- b. pjesëmarrjes aktive dhe të sukseshme në projekte të ndryshme, sidomos ato që financohen nga BE, me kontribut në hartimin e kurrikulave të reja dhe përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, në punën kërkimore për fusha zhvillimi me interes për vendin dhe në proceset demokratizuese;

c. organizimi i programeve për diploma të përbashkëta.

Të gjitha këto marrëveshje bashkëpunimi të lartpërmendura dhe të tjera, kanë shërbyer në kuadër të zhvillimit strategjik të universitetit, ndërkombëtarëzimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor, praktikës mësimore të studentëve, si dhe punësimit të tyre. Mund të përmendim, leksionet e hapura nga personalitete të njohur vendas dhe ndërkombëtar, të cilët kanë referuar për studentët e ciklit të parë dhe të dytë tematika të lidhura me fushat përkatëse të studimit të studentëve.

Zyra e Bashkëpunimit Institucional dhe Zhvillimit të Projekteve është një njësi ndër departamentale e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, e cila identifikon mundësitë e partneriteteve dhe aplikimeve sipas thirrjeve, aplikon dhe lehtëson dorëzimin e projekt-propozimeve në emër të universitetit, negocion dhe zbaton marrëveshjet, si dhe asiston fakultetet dhe stafin duke ofruar mentorim për projektet e fituara.

Disa nga detyrat që Zyra e Bashkëpunimit Institucional dhe Zhvillimit të Projekteve ka kryer janë përsa mëposhtë:

- Ø Identifikon thirrjet për projekte kërkimore – shkencore dhe zhvillimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përgatit paketën informuese dhe bën thirrje stafit për bashkëpunime.
- Ø Aplikon në thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare në emër të Universitetit.
- Ø Zbaton dhe menaxhon projektet e fituara – mbështet dhe supervizon stafin në fazën zbatuese të projektit.
- Ø Identifikon mundësi të reja për partneritete, duke synuar zgjerimin e rrjetit të partnerëve lokal, rajonal dhe atyre ndërkombëtar.
- Ø Merr pjesë në konferenca dhe evente të ndryshme për të rritur vizibilitetin e kësaj njësie të UMSH-së, për të gjetur ura të reja bashkëpunimi me shoqërinë civile, qeverinë, median dhe universitetet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Ø Mbështet me dokumentacion, me shkrim dhe menaxhim project idete e stafit akademik

### 1. Projektet e zbatuara gjatë vitit 2024/2025

Gjatë vitit akademik 2024/2025, ka vazhduar zbatimi dhe ndjekja e aktiviteteve të projekteve ndërkombëtare Erasmus + CBHE, me financim të BE-së si dhe atyre të fituara rishtaz. Tabela e mëposhtme paraqet projektet e aplikuar gjatë vitit 2024/2025.

ONGOING PROJECTS 2025							
N o	Project Acronym/Title	Program me	Call	Coordinator	Partners	Role (COO, BEN, AE, OTHER)	Duratio n
1	<b>DIGITCRESHE</b> ( Digital Transformation in the Western Balkans Education) Project number: 101082872	ERASM US Lump Sum Grants	ERASMUS -EDU- 2022- CBHE- STRAND- 1	INSTITUTO POLITECNICO DO PORTO (Pporto)	1) VISOKA SKOLA BANJA LUKA COLLEGE (BLC), 2) INTERNACIONAL NIOT UNIVERZITET EUROPA PRIMA - SKOPJE (EUROPA PRIMA), 3)QENDRA PER STUDIME KRAHASUESE DHE NDERKOMBETAR E (CCIS), 4)Fachhochschule Dortmund (FHD), 5) INTERNACIONAL	Partner(BEN )	2023- 2025 (24 months)

					NI UNIVERZITET TRAVNIK (IUT),		
					6)MESDHEU EDUCATION SHPK (MUA), PIC		
					7)UNION OF THE MACEDONIAN PROFESSIONAL ASSOCIATIONS IN THE CREATIVE INDUSTRY (UMPAKI Skopje),		
					8)UNIVERZITET MEDITERAN PODGORICA PRIVATNA USTANOVA (UNIM),		
					9)DIMIOURGIKI SKEPSI ANAPTYXIS (CRE.THI.DEV),		
					10)BARLETI UNIVERSITY (UMB),		
					11)JAVNA USTANOVA UNIVERZITET CRNE GORE PODGORICA (UOM),		
					12)PANEPISTIMIO THESSALIAS (UTH),		

					13)NEW BULGARIAN UNIVERSITY (NBU),		
					14) INSTITUTE FOR TECHNOLOGICAL TRANSFER AND INNOVATION (ITTI),		
2	<b>WEBJOU</b> (WEster n Balkan higher educational courses in data JOUrnalismju) Project number: 101083122	ERASM US	ERASMUS -EDU-2022-CBHE-STRAND-2	UNIVERSITA DEGLI STUDI DELLA TUSCIA (UNITUS),	1)UNIVERSIDADE NOVA DE LISBOA (UNL), 2) DATANINJA SOCIETA A RESPONSABILITA LIMITATA SEMPLIFICATA (DTNJ), 3)EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE (UET), 4)MESDHEU EDUCATION SHPK (MUA), 5)UNIVERSITETI ALEKSANDER MOISIU DURRES (UAMD), 6) KOLEGJI UNIVERSUM O.P (UC),	PARTNER(BEN)	2023-2025 (24 months)

					7)RIT KOSOVO (A.U.K) College (AUK), PIC		
					8)UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA (UKZ),		
					9)UNIVERZITET U NOVOM SADU (UNS),		
					10)UNIVERSITETI I TIRANES (UT),		
3	<b>U2SID</b> (University to society collaboration for inclusive digital transformation in the Western Balkans) Project number: 101083131	ERASM US	ERASMUS -EDU- 2022- CBHE	Universiteti I Shkodres Luigj Gurakuqi(ULG SHK), Shkoder	1)UNIVERSITETI FAN S NOLI KORCE (UNKO) 2) MESDHEU EDUCATION SHPK (MUA) 3) QENDRA SHKENCE DHE INOVACION PER ZHVILLIM (CENTER SCiDEV) 4) QENDRA PER STUDIME KRAHASUESE DHE NDERKOMBETAR E (CCIS) 5) AGJENCIA KOMBETARE E KERKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT (NASRI)	PARTNER( BEN)	2023- 2025

					6) JAVNA USTANOVA UNIVERZITET CRNE GORE PODGORICA (UOM)		
					7) UNIVERZITET U BEOGRADU (UniBelgrade)		
					8) UNIVERSITA DEL SALENTO (UNILE)		
4	LAIA( Laboratory on Artificial Intelligence in Albania and Kosovo) Project number: 101128818	ERASMUS	ERASMUS -EDU-2023-CBHE	UNIVERSITY OF PIRAEUS RESEARCH CENTER (UPRC),	1) SYDDANSK UNIVERSITET (SDU), 2) MESDHEU EDUCATION SHPK (UMSH), 3) UNIVERSITET ALEKSANDER XHUVANI ELBASAN (UNIEL), 4) UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES (UBT), 6) KOLEGJI UNIVERSUM O.P (UC), 7) UNIVERSITETI UKSHIN HOTI (UNI-PRIZREN),	PARTNER(BEN)	2024-2026 (36 months)

5	DRU(Disaster-Resilient-Universities)	ERASMUS+	KA220-HED - Cooperation partnerships in higher education (KA220-HED)	PANEPISTIMIO IOANNINON	1) PANEPISTIMIO IOANNINON	PARTNER(BEN)	01/09/2024-31/08/2026
					2)UNIVERSITATEA OVIDIUS DIN CONSTANTA		
					3) MESDHEU EDUCATION SHPK		
					4) Istituto ad ordinamento universitario "Scuola Superiore Carolina Albasio"		
					5) JAVNA USTANOVA UNIVERZITET U ZENICI UNIVERSITAS STUDIORUM ZENICAENSIS (EUR)		
6	HeGenAi (Generative AI for Assessment and Feedback in Higher Education) Project number: KA220-HED-2025-001	ERASMUS+	2025 – EAC/A08/2024 (C/2024/6983)	DANMARKS TEKNISKE UNIVERSITET	1) DANMARKS TEKNISKE UNIVERSITET	PARTNER(BEN)	01/09/2025-31/08/2028
					2) UNIVERSITET ALEKSANDER XHUVANI ELBASAN		
					3) BRANDENBURGIS CHE TECHNISCHE UNIVERSITAT COTTBUS-SENFTENBERG		

					4)PALESTINE TECHNICAL UNIVERSITY - KADOORIE (PTUK)		
					5) AN-NAJAH NATIONAL UNIVERSITY		
					6) MESDHEU EDUCATION SHPK		
					7)Chalmers tekniska högskola AB		
7	<b>S.A.M.E.R.</b> (SCHOOLS' ABILITY TO ADAPT IN THE MODERN EDUCATIONAL CONTEXT: NAVIGATING RESILIENCE)	Erasmus+	KA220-SCH - Cooperation partnerships in school education  (KA220-SCH)	SMK AUKŠTOJI MOKYKLA	1) SMK AUKŠTOJI MOKYKLA  2) PRIVATE SCIENTIFIC INSTITUTION,INSTITUTE FOR RESEARCH IN ENVIRONMENT, CIVIL ENGINEERING AND ENERGY, SKOPJE  3) MESDHEU EDUCATION SHPK  4) OLEMISEN BALANSSIA RY  5) Klaipeda "Vetrunge" gymnasium	PARTNER(BEN)	01/09/20 25- 31/10/20 27

					6) TALLINNA TEHNIKAULIKOO L		
					7) American High School Skopje		
<b>8</b>	<b>101179359</b> - <b>CORE-ED</b> <b>ACADEMY</b> Fostering Inclusion and Shared Values in Juvenile Justice through Correctional Pedagogy and Specialist Professionalization , Empowered by the 'LiberateSkills' Correctional Excellence Pact for Skills	Erasmus+	ERASMUS -EDU- 2024- CBHE	Universiteti Luarasi	1) LUARASI UNIVERSITY 2) MESDHEU EDUCATION SHPK 3) SHERBIMI I KONTROLLIT TE BRENDSHEM NE SISTEMIN E BURGJEVE 4) KOLEGJI AAB 5) UNIVERSITETI NDERKOMBETAR PER BIZNES DHE TEKNOLOGJI UBT SHPK 6) VISOKA SKOLA CEPS CENTAR ZA POSLOVNE STUDIJE KISELJAK 7) VISOKA SKOLA CEPS CENTAR ZA POSLOVNE STUDIJE KISELJAK 8) JAVNA USTANOVA UNIVERZITET	PARTNER( BEN)	01/01/20 25- 31/12/20 27

					CRNE GORE PODGORICA		
					9) PANEPISTIMIO AIGAIU		
					10) RESEARCH INNOVATION AND DEVELOPMENT LAB PRIVATE COMPANY		
					11) UNIVERSITATEA DE VEST DIN TIMISOARA		
					12) CENTRUL PENTRU PROMOVAREA INVATARII PERMANENTE TIMISOARA ASOCIATIA		
					13) QENDRA PER STUDIME KRAHASUESE DHE NDERKOMBETAR E		

#### e. STUDENTËT

Studentët në UMSH në vitin akademik 2024/2025 u pranuan bazuar në kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve në vitin akademik 2024/2025 të miratuara nga Senati Akademik i UMSH. Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve realizohet në përputhje me ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”, Statutin, Rregulloren Organizative të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” dhe Rregulloret e Programeve të Studimit përkatëse.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka pranuar dhe pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore dhe në rregulloren e UMSH.

Të dhënat specifike në lidhje me ecurinë dhe mbarëvajtjen e studentëve në vitin akademik 2024/2025 lidhur me numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar programet e studimit të organizuara në UMSH, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe që përbëjnë prioritet kombëtar, numrin e studentëve të shkëlqyer, numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit, pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar gjenden në Tabelën 8. Përqindja e kalueshmërisë të studentëve kalues në vit dhe përqindja e kalueshmërisë të studentëve që diplomohen gjenden në Tabelën 9.

Shënim për leximin e Tabelave 8 dhe 9:

*\*Numri i studentëve që kanë marrë pjesë në disa nga projektet e bashkëpunimi ndërkombëtare është 156*

*\*\*Në numrin e studentëve të diplomuar në raundin e I, sipas programeve të studimit në vitin akademik 2024/2025, janë përfshirë edhe ata të cikleve të kaluara akademike*

Të dhënat mbi numrin e studentëve të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe të dhëna të tjera specifike i gjeni në Aneksin 1.

*Tabela 8.*

69

Nr.	Programi i studimit	Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për herë të parë sipas niveleve dhe programeve të studimit në vitin akademik 2024/2025	Numri i studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar	Numri i studentëve të transferuar në UMSH	Numri i studentëve të shkëlyer	Numri i studentëve të çregjistruar	Numri i studentëve që kanë përfunduar bursa të pjesëshme apo të plota	Pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar*
1	Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Financë Bankë dhe Kontabilitet	97		53	25	4	52%	
2	Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Administrim Biznesi	216		116	20	4	52%	
3	Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil: Biznes dhe Ligi	7		2			52%	
4	Bachelor në Informatikë me profil Inzhineri Informatike	145	330	65	30	1	53%	
5	Bachelor në Informatikë me profil Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	34	108	18	10	1	51%	
6	Bachelor në Informatikë me profil Informatikë Biznesi	128	288	71	25	14	55%	
7	Program Studimi i Integruar në Drejtësi	82		27	10		56%	
8	Bachelor në MIN	17		7	2	1	55%	
9	Bachelor në Shkenca Politike me profil: Politikat e Integritit dhe Qeverisje	15		8	2		61%	
10	Bachelor në Shkenca Politike me profil: Administratë Publike	45		18	5		30%	
11	Bachelor në Studime Psikosociale	42		17	8		61%	
12	Bachelor në Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun	12		7	2		56%	
13	Bachelor në Mësuesi për Arsimin parashkollor	29		4	10	1	39%	
14	Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor	21		4	8	5	71%	
15	Master i Shkencave në Financë Bankë me profil Bankat dhe Tregjet Financiare	60		10	15	1	44%	
16	Master i Shkencave në Financë Bankë me profil Teknologjite e Reja Financiare	57		5	8		45%	
17	Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Spërmarrja dhe Inovacioni	85		5	15	1	45%	
18	Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Marketing, Shitje dhe Komunikim	60		3	10		52%	
19	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arsimit	4					52%	
20	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Arti	1				1		
21	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Shëndeti	10				3	32%	
22	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim i Pasurive të Pakujshme	12			2	4	32%	
23	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil Menaxhim Turizmi	10			2	5	32%	
24	Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes	15			3	2	32%	
25	Master i Shkencave në Informatikë me profil Sistemet e Informacionit në Biznes	40		1	10	2	30%	
26	Master i Shkencave në Informatikë me profil Inzhineri Software	80		4	19		55%	
27	Master Profesional në Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar	35			5		55%	
28	Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare	35		1	10	2	31%	
29	Master i Shkencave në E Drejtë Publike	45		1	15		46%	
31	Master i Shkencave në Marrëdhënie Nderkombetare me profil Siguri Nderkombetare	20			5		37%	
32	Master i Shkencave në Marrëdhënie Nderkombetare me profil Biznes Nderkombetar	15			5		31%	
33	Master i Shkencave në Marrëdhënie Nderkombetare me profil Komunikim Nderkombetar	15			5		15%	
34	Master Profesional në Marrëdhënie Nderkombetare me profil Studime Mesdhetare	0						
35	Master Profesional në Marrëdhënie Nderkombetare me profil Studime Europiane	5				2	55%	
36	Master i Shkencave në Studime Politike dhe Strategji Ekonomike të Zhvillimit	43		3	12		50%	
37	Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Administratë Publike	30			5	7	50%	
38	Master Profesional në Shkenca Politike me profil Qeverisje Vendore	3				1	50%	
39	Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Politikat Sociale	2						
40	Hartim dhe Menaxhim Projektesh	25				20	46%	
41	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Organizative	14		1	4	1	46%	
42	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Komunitare	15			3	1	46%	
43	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Këshillim dhe Psikoterapi me orientim Njohës Sjellor	17			5	1	33%	
44	Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Specialist Rrjetash Kompjuterike	25		2			4%	
45	Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajise Elektronike	9				1	4%	
46	Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Software dhe Dëgjatizim	25					4%	
47	Diplomë Profesionale në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit	60				1	7%	
48	Bachelor në Infermeri e Përgjithshme	39		8	8		11%	
49	Bachelor në Fizioterapi	18		2	5		7%	
50	Bachelor në Teknik Laboratori	18		2	5	1	6%	
51	Program Studimi i Çkllit të Tretë Doktoratë në Shkenca Ekonomike						41%	

Tabela 9.

	Programi i studimit	Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit në vitin akademik 2024/2025**	Kalueshmëria mesatare në % e studentëve në vitin akademik 2024/2025				
			Kalueshmëria mesatare në % në vitin I 2024/2025	Kalueshmëria mesatare në % në vitin II 2024/2025	Kalueshmëria mesatare në % në vitin III 2024/2025	Kalueshmëria mesatare në % në vitin IV 2024/2025	Kalueshmëria mesatare në % Diplomime 2024/2025
1	Bachelor në Shkencë Ekonomike me profil: Financë Bankë dhe Kontabilitet	70	80%	85%			
2	Bachelor në Shkencë Ekonomike me profil: Administrim Biznesi	151	70%	75%			
3	Bachelor në Shkencë Ekonomike me profil: Biznes dhe Ligj	13	95%	98%			
4	Bachelor në Informatikë me profil Inxhinieri Informatike	89	80%	85%			
5	Bachelor në Informatikë me profil Teknologji Informacioni	41	83%	86%			
6	Bachelor në Informatikë me profil Informatikë Biznesi	98	65%	75%			
7	Program Studimi i Integruar në Drejtësi	67	80%	85%	85%	80%	
8	Bachelor në MIN	5	85%	80%			
9	Bachelor në Shkencë Politike me profil: Politikat e Integritit dhe Qeverisje	10	80%	75%			
10	Bachelor në Shkencë Politike me profil: Administratë Publike	21	85%	70%			
11	Bachelor në Studime Psikosociale	24	85%	87%			
12	Bachelor në Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun	5	60%	70%			
13	Bachelor në Mësuesi për Arsimin parashkollor	37	85%	80%			
14	Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fëmijë	7	85%	85%			
15	Master i Shkencave në Financë Bankë me profil Bankat dhe Tregjet Financiare	51	85%				
16	Master i Shkencave në Financë Bankë me profil Teknologji e Reja Financiare	39	80%				
17	Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Sipërmarrja dhe Inovacioni	61	90%				
18	Master i Shkencave në Administrim Biznesi me profile: Marketing, Shitje dhe Komunikim	45	83%				
19	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Arsimit	3	65%				
20	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Arti	0	0%				
21	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Shëndeti	3	30%				
22	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim i Pasurive të Paluajtshme	3	100%				
23	Master Profesional në Menaxhim Biznesi me profil: Menaxhim Turizmi	2	30%				
24	Master Profesional në Sisteme Informacioni në Biznes	11	75%				
25	Master i Shkencave në Informatikë me profil Sistemet e Informacionit në Biznes	24	80%				
26	Master i Shkencave në Informatikë me profil Inxhinieri Software	55	85%				
27	Master Profesional në Auditim i Brendshëm dhe Kontrolli Financiar	29	90%				
28	Master i Shkencave në E Drejtë Civile dhe Tregtare	23	95%				
29	Master i Shkencave në E Drejtë Publike	45	87%				
30	Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare	26	85%				
31	Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Mesdhetare	0	0%				
32	Master Profesional në Marrëdhënie Ndërkombëtare me profil: Studime Europiane	2	60%				
33	Master i Shkencave në Studime Politike dhe Strategjitë Ekonomike të Zhvillimit	34	92%				
34	Master Profesional në Shkencë Politike me profil: Administratë Publike	16	65%				
35	Master Profesional në Shkencë Politike me profil:Qeverisje Vendore	2	95%				
36	Master Profesional në Shkencë Politike me profil: Politikat Sociale	1	50%				
37	Master Profesional në Hartim dhe Menaxhim Projektesh	1	4%				
38	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Organizative	10	95%				
39	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Psikologji Komunitare	6	95%				
40	Master i Shkencave në Psikologji me profil: Këshillim dhe Psikoterapi me orientim Njohës Sjellor	14	97%				
41	Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Specialist Rrjetash Komputeri	12	90%				
42	Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Pajisje Elektronike	3	50%				
43	Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike me profile: Teknik për Software dhe Aplikime	10	65%				
44	Diplomë Profesionale në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit	24	50%				
45	Program Studimi i Ciklit të Tretë Doktoratë në Shkencë Ekonomike						

Referuar nenit 50 të Rregullores Organizative të Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë” janë përcaktuar modalitete në lidhje me propozimin e kritereve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët duan të vazhdojnë studimet e ciklit të parë Bachelor apo Master. Pranimi është i lidhur dhe me plotësimin e kritereve të përcaktuara sipas akteve nënligjore në fuqi dhe kritereve të veçanta të përcaktuara nga institucioni.

Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në çdo fakultet bëhet nga një komision i caktuar nga Dekani, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe nga shqyrtimi i dosjes personale të kandidatit.

Kuotat e studentëve që mund të regjistrohen në secilin program të studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes propozohen nga njësitë bazë dhe kryesore sipas akteve ligjore dhe administrative të Institucionit dhe miratohen nga Senati Akademik.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë nëpërmjet njësive të posaçme përpunon të dhëna në lidhje me numrin e përgjithshëm të studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë e të dytë të studimeve. Gjithashtu, në funksion të evidentimit të saktë të të dhënave sa i përket, numrit të studentëve, institucioni përpunon të dhëna dhe sa i përket numrit të studentëve në dalje ndër vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve apo problematika në lidhje me to.

Pranë UMSH funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës, e cila ndihmon studentët në drejtimet e mëposhtme:

- Orientimi i studentëve për vijimin e studimeve në ciklet e mëpasme të studimit, duke u mbështetur në aftësitë personale dhe talentet e tyre dhe duke shfrytëzuar hapësirat që ofrojnë institucione të ndryshme.
- Orientimi për pjesëmarrjen e studentëve në projekte studimore që mund të hartohen ose të zbatohen nga institucioni në bashkëpunim me strukturat jashtë tij. Në disa raste studentët angazhohen në procesin e anketimeve të tregut ose të mbledhjes së rezultateve nga vëzhgime empirike.
- Stimulimi i studentëve për pjesëmarrjen në aktivitete dhe konkurse kombëtare e ndërkombëtare është një drejtim tjetër i këshillimit dhe tutoriatit studentor.

Personeli akademik luan një rol këshillues dhe orientues të studentëve edhe për çeshtje të punësimit. Për disa shërbime të lidhura ngushtë me këshillimin e studentëve, UMSH i është drejtuar shoqërive të specializuara në tregun shqiptar.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë asistencës së vazhdueshme të studentëve të rinj duke u dhënë informacionet në lidhje me programin e studimit që duan të

ndjekin. Sistemi i informimit realizohet që në javën e parë, që cilësohet si java e parë e informimit të përgjithshëm, nëpërmjet broshurave të ndryshme, sekretarisë dhe sistemit të tutorazhit.

Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit bëhen publik në faqen zyrtare të UMSH, në broshurën informuese dhe gjatë fushatës së marketingut.

Procesi i informimit të studentëve të ardhshëm koordinohet nga Sekretaria Mësimore dhe Pranimet në bashkëpunim me ZKSK. Në aktivitetet kryesore të këtij procesi përfshihen:

- Këshillimi pedagogë-aplikantë në ambjentet e UMSH gjatë fazës së regjistrimeve.
- Fushata mediatike – kombinon reklamat televizive dhe ato në median e shkruar, daljet e përfaqësuesve/ pedagogëve në emisione televizive, dhe përdorimin e rrjeteve sociale.

UMSH mirëpret studentët e huaj në përputhje me udhëzimet e MASR, qofshin ata vendas apo të huaj. Oraret e pritjes së studentëve shpallen në ambjentet e institucionit në këndet e afishimit si dhe publikohen në faqen zyrtare. Raporti numerik personel akademik/ student në UMSH është i tillë që të sigurohet arsimimi cilësor, përkujdesja dhe ndihma për studentët gjatë gjithë procesit të mësimit dhe garantimi i aktiviteteve jashtëshkollore me studentët.

Për funksionim sa më të drejtë dhe transparent të tutoriatit, ZKSK ka zhvilluar 1 herë në javë takimet e Tutoriatit me studentët në Bachelor sipas programeve. Pas çdo takimi janë realizuar procesverbalet e takimit. Takimet e klubeve studentore janë zhvilluar sipas departamenteve, sipas programit të studimit. Takimet janë zhvilluar në formë të tryezave të rrumbullakëta. Pedagogu drejtues i klubeve, ka njoftuar paraprakisht për takimin dhe tematikën e radhës. Këto takime janë publikuar ne FCB dhe Insta të Këshillit studentor. Pedagogët kanë ftuar në ne keto klube edhe studentët e regjistruar në këtë vit akademik. Për çdo takim ka foto dhe përmbledhje të takimit të printuar dhe të futur në dosjen e ZKSK për këtë vit akademik. Pedagogët e ZKSK janë angazhuar edhe në realizmin e Focus Grupeve ku është tërhequr mendimi i studentëve për lëndët dhe pedagogët e programit të studimit që ndjekin. Edhe ky proces është zhvilluar online dhe është dokumentuar në procesverbale në dosjen e ZKSK. Këtë vit janë realizuar zgjedhjet e pjesshme të këshillit studentor, duke qenë se sipas rregullores së vetë këshillit zgjedhjet bëhen një herë në dy vjet dhe të pjesshmet një herë në vit.

- Aktivitete të Këshillit studentor.
  - Këshilli studentor ka qenë shumë aktiv gjatë gjithë vitit akademik 2024/2025 me takime, rubrika reflektive dhe shumë elemente të tjerë, të cilët janë publikuar në FCB, INSTA dhe Faqen zyrtare të UMSH, në rubrikën përkatëse të këshillit studentor. Fotot e aktiviteve janë printuar dhe gjenden në dosjen e ZKSK.

#### **f. Bashkëpunimi dhe komunikimi me MASR**

Edhe gjatë vitit akademik 2024/2025, UMSH ka ruajtur kontakte dhe korrespondencë korrekte me Ministrinë e Arsimit Sporteve dhe Rinisë, Qendrën e Shërbimeve Studentore, Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë – ASCAL dhe të gjitha institucionet e tjera të varësisë, në respekt të detyrimeve që burojnë nga Ligji dhe aktet e tjera që rregullojnë aktivitetin e UMSH-së, si dhe të veprimtarisë rutinë të institucionit.

Gjatë këtij viti akademik është komunikuar me MASR dhe institucionet e varësisë, gjithashtu, në mënyrë korrekte, për: kërkesa për hapjen e programeve të reja; miratimin e riorganizimeve të programeve; raportimi i të dhënave statistikore të përvitshme; miratimin e formës së re të diplomës dhe suplementit të saj dhe regjistrimin e diplomave; procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve; të dhënat e studentëve pranë QSHA-së dhe matrikulimi i tyre; kuotat dhe kriteret e pranimeve në vitin akademik 2024/2025; të dhëna për infrastrukturën e kërkimit shkencor; raportimet e përvitshme pranë sistemit AMS të ASCAL në lidhje me aktivitetin e UMSH (azhurnim i personelit, të dhëna për programet e studimit, të dhëna për studentët, etj), kërkesa dhe sqarime të ndryshme për mbarëvajtjen e komunikimit dhe marrëdhënies me këto instance. Në të gjitha rastet është gjetur mirëkuptim dhe angazhim i institucioneve shtetërore për zbatimin me korrektesë të ligjit.

UMSH i është përgjigjur me korrektesë dhe gadishmëri të plotë, të gjitha thirrjeve për bashkëpunim dhe është përfaqësuar në të gjitha aktivitetet e organizuara nga MASR dhe institucionet e saj të varësisë.

## **B. Raporti i Bordit të Administrimit**

Bordi i Administrimit i UMSH është organi më i lartë Kolegjal Administrativ i cili siguron përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Rezultatet e financimi, menaxhimi dhe administrimi i UMSH pasqyrohen në Pasqyrat Financiare të tij. Institucioni ofron shërbime duke u fokusuar në misionin e tij dhe mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësi e auditimit të brendshëm e Institucionit. Auditimi i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij, në Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Ajo ndjek zbatimin e të gjithë procedurave financiare për realizimin e të ardhurave, kryerjen e investimeve, shpenzimeve, pagesave, mbajtjen e dokumentacionit kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore të UMSH, sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, bazuar në Rregulloren Organizative të UMSH, neni 31.

Pasqyrat financiare të Institucionit janë transparente dhe pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të tij, gjendje e cila jep siguri për vazhdimësinë e aktivitetit të institucionit.

Pasqyrat financiare auditohen edhe nga ekspertët e jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria Crowe Horwath AL shpk.

Situata financiare e Institucionit plotëson të gjitha standardet e nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen e plotë të aktivitetit duke siguruar të gjitha kriteret e kërkuara ligjore të standardeve të Cilësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi (neni 32, Rregullore Organizative UMSH).

Veprimtaria e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë mbështetet bazuar në përcaktimet e Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Për të realizuar misionin e vet dhe për të garantuar funksionalitetin standardet, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, është organizuar në njësi akademike dhe njësi të tjera ndihmëse në përputhje me Statutin e tij. Në Aneksin 2 do të gjeni strukturën e përgjithshme organizative të UMSH.

Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit, realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim dhe të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga UMSH apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare, gjenden të pasqyruara në Tabelën 10.

Nr.	Emertimet/Vitet	2024-2025
		Fakt
	TE ARDHURAT	
1	Te ardhura nga tarifat	560164
2	Te Ardhura nga Projektet	9250
3	Te Ardhura nga burime te tjera	7113
4	Totali I burimeve $4=1+2+3$	576527
	PERDORIME	
5	Pagat per mesimdhënie dhe administrimin	194591.8715
6	Paga per punen kerkimin shkencore	67,682.23
7	Pagesa per projektet kerkimi	8120
8	Shpenzime administrative dhe te pergjithshme	173,626.80
9	Shpenzime per kerkimi zhvillim	6,584.40
10	Shpenzime për Investime & teknologji	58,965.40
11	Totali i Perdorimeve $(11=5+6+7+8+9+10)$	509,570.70
12	Rezerve burimesh per investime & kontigjence	63960
13	Bursa referuar bursave	113300

**Shënime:**

- *Institucioni mbështetur në planin strategjik po krijon rezerva burimesh me qëllim investimin për zgjerimin e ambienteve, rikonstrukcionin dhe plotësimin me pajisje dhe teknologji bashkëkohore.*
- *30% e rezervës së burimeve planifikohet për qëndrueshmërinë financiare për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit të tij.*
- *Të ardhurat nga kontributet e studentëve paraqiten NETO, pas zbritjes së bursave.*

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë realizon aktivitetin e vet financiar konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e UMSH. Në Aneksin 3, do të gjeni ekstrakte të shkarkuara nga platforma E-Albania në lidhje me shlyerjen së detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga ana e tij.

Godinat e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë gjenden në zonat më të preferuara të Tiranës dhe janë vendosur në dispozicion të studentëve me infrastruktura të reja, moderne e të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor të një niveli të lartë. Të dhëna specifike gjenden në Tabelën 11.

*Tabela 11.*

<b>Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>
Salla për leksione	13	944
Klasa për seminare	18	686
Salla për aktivitete promovuese	1	104
Laboratorë informatike	5	215
Laboratorë për lëndët	2	95
Salla interneti	1	52
Salla për bibliotekë	4	157
Mjedis për fotokopjime, librari etj	2	22
Zyrë informacioni për studentët	2	18
Korridore/holle	14	980
Mjedise shërbimi për të tretë	2	90
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	2	102
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	430
Nyje hidrosanitare për studentët	59	242

<b>Mjediset për stafin:</b>	<b>Sasia</b>	<b>Sipërfaqja</b>
Zyra për Dekanin/zv dekanin	8	188
Zyra për sekretarinë mësimore	4	60
Zyra për departamentet	8	262.6
Zyra për personelin akademik	5	108
Zyrë për financën	1	30
Zyrë për Njësinë e SBC	1	25.5
Salla për mbledhje	1	58
Mjedis për stafin e shërbimit	2	64
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	5	26
Arkiva	2	50



# ANEKSI 1

## TE DHENA STUDENTET

Dokumentacioni i dorëzuar në QSHA për regjistrimet e vitit akademik 2024/2025  
me tabelat e plotat të të dhënave të studentëve



# ANEKSI 2

## STRUKTURA

UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPERISE



# ANEKSI 3

DEKLARATA TË SHLYERJES TË DETYRIMEVE TATIMORE  
SIGURIMEVE SHOQËRORE E SHËNDETËSORE